



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

**RAPORT  
VJETOR  
2022**





ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

**Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB)**

**Adresa zyrtare:** Rr. "Ibrahim Rugova", Sky Tower 9/3, Tiranë

Regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendim Gjykate nr.1153, datë 14.04.1999

**NIPT: K51626015F**

Raporti Vjetor është një botim vjetor i përgatitur nga **Zyra Ekzekutive e AAB-së** i disponueshëm në format digjital në faqen e internetit **[www.aab.al](http://www.aab.al)**

Informacioni në këtë Raport mund të përdoret vetëm për qëllime jo fitimprurëse, duke përmendur "Raporti Vjetor 2022", botuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB).

Ndalohet ndryshimi i pjesshëm apo i plotë i përmbajtjes së këtij Raporti.

Design & Layout: **FCB AFIRMA**

# PËRMBAJTJA

<b>1. MESAZH NGA KRYETARI</b>	<b>4</b>
<b>2. STRUKTURA ORGANIZATIVE</b>	<b>6</b>
<b>3. ANËTARËT E SHOQATËS</b>	<b>9</b>
<b>4. ARRITJET NË VITIN 2022</b>	<b>10</b>
<b>5. FAKTE DHE SHIFRA PËR 2022 - SEKTORI BANKAR NË SHQIPËRI</b>	<b>12</b>
<b>6. SHTYLLAT KRYESORE TË AAB-SË</b>	<b>15</b>
PËRMIRËSIMI I KUADRIT RREGULLATOR DHE BASHKËPUNIMI ME AUTORITETET	15
TRANSFORMIMI I SEKTORIT BANKAR	17
TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI I PUNONJËSVE TË BANKËS	24
EDUKIMI FINANCIAR	28
MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE KOMUNIKIMET E BRENDSHME DHE TË JASHTME	31
<b>7. KOMITETET TEKNIKE - AKTIVITETET DHE ARRITJET</b>	<b>38</b>
<b>8. TAKIME TË TJERA</b>	<b>41</b>
<b>9. SHIFRA RRETH BANKAVE ANËTARE</b>	<b>45</b>
<b>10. PASQYRAT FINANCIARE</b>	<b>48</b>

# 1. MESAZH NGA KRYETARI

## I dashur Lexues,

Viti 2022 do të mbahet mend për sulmin e paprovokuar të Rusisë ndaj Ukrainës. Ishte kjo ngjarje e jashtëzakonshme që krijoi një varg pasojash për jetën ekonomike kudo në botë, shoqëruar me rritje të inflacionit dhe për pasojë të normave të interesit nga bankat qendrore, si dhe me rënien e fuqisë blerëse për individët dhe përkeqësim të nivelit të përgjithshëm të jetesës.

Industria bankare vijoi veprimtarinë e saj pa ndërprerje në këtë realitet të ri vetëm pak javë sapo kishte filluar viti financiar, duke qenë e detyruar të rishikojë planet e biznesit dhe prioritetet në varësi të zhvillimeve të reja.

Rezultatet vjetore tregojnë se rruga e zgjedhur nga bankat dhe modeli i biznesit të tyre ishin të qëndrueshme dhe fitimprurëse. Përshtatja ndaj ambientit të ri ekonomik me norma interesi të rritura e gjeti industrinë bankare të përgatitur, pa krijuar shqetësime për klientët dhe tregun. Viti 2022, nga pikëpamja e fitueshmërisë, është viti më i mirë i dekadës së fundit. Kjo ecuri pozitive jep besueshmëri dhe siguri jo vetëm te aksionarët për më shumë biznes në të ardhmen, por edhe për zhvillimin e tregjeve, dhe te klientët si për depozitat ashtu edhe për shërbimet dhe produktet që bankat ofrojnë. Nuk është rastësi që në studimin e zhvilluar në fund të vitit, industria bankare klasifikohet si industria më e besueshme në vend, më e mira nga të gjitha institucionet private dhe publike.

Rritja e kreditimit si për bizneset ashtu edhe për individët ishte një sfidë e fituar në 2022. Ruajtja e cilësisë së kredidhënies,



ku niveli i kredive me probleme mbetet në nivelin më të ulët të dekadës së fundit, përbën siguri për vlerësimin dhe marrjen përsipër të faktorëve të rrezikut të identifikuar në ekonominë tonë.

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) mbështeti nevojat dhe

kërkesat e anëtarëve, duke synuar zhvillime të reja në treg për të përfituar sa më shumë klientët bankarë. Kështu, në fillim të vitit, u vu në zbatim transferta në monedhën euro brenda vendit pa bankë korrespondente të huaj, duke ulur ndjeshëm kostot e transfertave për këtë monedhë.

Gjithashtu, me digjitalizimin e shërbimeve publike, bankat kanë hyrë në projektin e ofrimit të pagesës digjitale për shërbimin publik të marrë nëpërmjet e-Albania. Ky projekt është në fazën e konsolidimit dhe më tej të ofrimit për klientët.

Me përparësi AAB ka ndjekur zhvillimet për ndryshimet rregullatore dhe ligjore përkatëse për të lejuar hapjen e llogarisë në distancë për individin dhe për nënshkrimin elektronik. Është një projekt i nisur tashmë dhe jemi në pritje të përmbylljes së tij.

Viti 2022 shënoi edhe përfundimin, për momentin, të konsolidimit të sektorit bankar, me mbylljen e shitjes dhe transferimin e bankës Alpha te OTP Bank Albania. Tani sektori bankar përbëhet nga 11 banka, ndër të cilat pesë janë me kapital vendas.

AAB ka qenë aktive dhe pjesëmarrëse në çdo tryezë ku janë diskutuar projekt rregullorë, projekt udhëzime, projekt ligje dhe/ose projekte për zhvillime sektoriale apo të ekonomisë me çdo aktor vendas dhe të huaj, si Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Komisioni Parlamentar për Financat dhe Ekonominë, FMN, Banka Botërore, Delegacioni i BE, etj.

Më shumë mbi arritjet e AAB në pesë shtyllat kryesore të veprimtarisë së saj, ju ftoj të shfletoni këtë raport. Janë shumë veprimtari, takime, trajnime, publikime dhe organizime që flasin më së miri për përkushtimin dhe angazhimin e anëtarëve në zhvillimin e industrisë bankare dhe të ekonomisë.

Me respekt,

**Bledar Shella**

Kryetar, Shoqata Shqiptare e Bankave

& Drejtor i Përgjithshëm, Banka OTP Albania

A handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Bledar Shella', is placed over the printed name and title.

# 2. STRUKTURA ORGANIZATIVE

Organizata e AAB-së përbëhet nga këto organe:

- Asambleja e Anëtarëve - Organi vendimmarrës;
- Bordi Mbikëqyrës - Organi politikbërës dhe monitorues;
- Sekretari i Përgjithshëm - Organi ekzekutiv;
- Zyra Ekzekutive, Komitetet Teknike dhe Grupet e Punës - Organet mbështetëse.

## 2.1 Asambleja e Anëtarëve

Asambleja është organi më i lartë vendimmarrës i AAB-së. Asambleja e Anëtarëve përbëhet nga:

- Kryetari;
- Anëtarët.

Kryetari i zgjedhur i Bordit Mbikëqyrës është Kryetari i Asamblesë së Anëtarëve. Në fund të vitit 2022, Asambleja e Anëtarëve përbëhej nga 11 anëtarë.

Lista e mëposhtme përshkruan në detaje Bankat Anëtare të AAB-së dhe të Asamblesë së Anëtarëve:

- |   |   |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Banka Amerikane e Investimeve</b><br/>Andi Ballta,<br/>Drejtor i Përgjithshëm</li> </ul>                        | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Banka Raiffeisen Albania</b><br/>Christian Canacaris,<br/>Drejtor i Përgjithshëm</li> </ul> |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Banka Kombëtare Tregtare</b><br/>Seyhan Pencabligil,<br/>Drejtor i Përgjithshëm<br/>dhe Anëtar Bordi</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Banka OTP Albania</b><br/>Bledar Shella,<br/>Drejtor i Përgjithshëm</li> </ul>              |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Banka Credins</b><br/>Maltin Korkuti,<br/>Drejtor i Përgjithshëm</li> </ul>                                     | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Tirana Bank</b><br/>Dritan Mustafa,<br/>Drejtor i Përgjithshëm</li> </ul>                   |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>First Investment Bank Albania</b><br/>Bozhidar Todorov,<br/>Drejtor i Përgjithshëm</li> </ul>                   | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Union Bank</b><br/>Flutura Veipi,<br/>Drejtor i Përgjithshëm</li> </ul>                     |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Intesa Sanpaolo Bank në Shqipëri</b><br/>Alessandro D'Oria,<br/>Drejtor i Përgjithshëm</li> </ul>               | <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>United Bank of Albania</b><br/>Orfea Dhuci,<br/>Drejtor i Përgjithshëm</li> </ul>           |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Banka Procredit Albania</b><br/>Mirsad Haliti,<br/>Anëtar i Bordit Drejtues</li> </ul>                          |   |



## 2.2 Bordi Mbikëqyrës

Bordi Mbikëqyrës është organi më i lartë politikbërës, kontrollues dhe monitorues i Shoqatës. Ky Bord përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe kryesohet nga Kryetari i zgjedhur nga Asambleja ose, në mungesë të tij, nga Zëvendëskryetari i zgjedhur, i cili mund të veprojë me kompetenca të barabarta.

Bordi Mbikëqyrës ka pesë anëtarë, tre prej tyre zgjidhen nga përfaqësuesit e "Bankave Sistemike" (siç identifikohen nga BSH), dhe dy anëtarët e tjerë zgjidhen nga përfaqësuesit e bankave të tjera.

Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës zgjidhen nga Asambleja e Anëtarëve për një mandat dy vjeçar.

### Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës:



#### **BLEDAR SHELLA**

Kryetar  
Drejtor i Përgjithshëm,  
OTP Bank Albania



#### **SEYHAN PENCABLIGIL**

Zëvendës Kryetar  
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv  
dhe Anëtar Bordi,  
Banka Kombëtare Tregtare (BKT)



#### **MALTIN KORKUTI**

Anëtar  
Drejtor i Përgjithshëm,  
Banka Credins



#### **DRITAN MUSTAFA**

Anëtar  
Drejtor i Përgjithshëm,  
Banka e Tiranës



#### **BOZHIDAR TODOROV**

Anëtar  
Drejtor i Përgjithshëm,  
Fibank Albania

Z. Bledar Shella është aktualisht Kryetari i Bordit Mbikëqyrës të AAB-së.

## 2.3 Zyra Ekzekutive



**SPIRO BRUMBULLI**  
Sekretar i Përgjithshëm

Zyra Ekzekutive ka për detyrë të ndihmojë Organet Drejtuese të AAB-së në zbatimin e detyrave të tyre funksionale. Ajo drejtohet dhe mbikëqyret drejtpërdrejt nga Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës. Në përputhje me parashikimet e Statutit të AAB-së, Sekretari i Përgjithshëm është përfaqësuesi ligjor i AAB-së. Z. Spiro Brumbulli aktualisht gëzon postin e Sekretarit të Përgjithshëm të AAB-së.

## 2.4 Komitetet Teknike

AAB-ja themelon komitete teknike për të trajtuar në mënyrë periodike problemet kryesore brenda fushës së aktivitetit të saj. Bazuar te kompetencat e tyre profesionale, Komitetet e Përhershme Teknike janë organet që synojnë t'i ofrojnë Bordit Mbikëqyrës dhe Sekretarit të Përgjithshëm propozimet dhe përgjigjet e nevojshme në fushat e tyre specifike të përgjegjësisë. Krahas Komiteteve Teknike të Përhershme dhe në bazë të nevojave të Shoqatës, Bordi Mbikëqyrës është përgjegjës edhe për themelimin e Komiteteve Teknike Ndhimëse.

### 2.4.1 Komitetet Teknike të Përhershme

- **Komiteti Ligjor** / Albina Hasanaj, Kryetare, Banka Kombëtare Tregtare
- **Komiteti i Përputhshmërisë** / Bertina Hajdini, Kryetare, OTP Bank Albania\*
- **Komiteti i Menaxhimi të Rrezikut** / Elona Bollano, Kryetare Banka Kombëtare Tregtare
- **Komiteti i Financës dhe Kontabilitetit** / Juela Ahmeti, Kryetare, Raiffeisen Bank Albania
- **Komiteti i Burimeve Njerëzore** / Entela Zigori, Intesa Sanpaolo Bank Albania
- **Komiteti i Sigurisë së TIK dhe TI** / Irena Rrushaj, Kryetare, Union Bank
- **Komiteti i Auditit** / Ilir Rudi, Kryetar, Banka Amerikane e Investimeve

### 2.4.2 Komitetet Teknike Ndhimëse

- **Komiteti Ndhimës i Pagesave, Kartave, Digjitalizimit dhe Kanaleve Alternative** / Irida Huta, Kryetare, OTP Bank Albania
- **Task Forca për Sigurinë Kibernetike** / Reglendi Xhango, Kryetar, Intesa Sanpaolo Bank Albania

\*Deri në fund të muajit tetor 2022



# 3. ANËTARËSIMI

## Anëtarësimi i AAB-së në organizatat ndërkombëtare:

- Federata Evropiane e Bankave (EBF)
- Shoqata e Bankave për Evropën Qendrore dhe Lindore (BACEE)
- Forumi i Shoqatave të Bankave Interbalkan
- Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC)



## Anëtarësimi i AAB-së në organizatat kombëtare:

- Këshilli Ekonomik Kombëtar
- Këshilli Tatimor
- Këshilli Kombëtar i Punës
- Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave
- Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL)

## 4. ARRITJET GJATË VITIT 2022

- ▶ Asambleja e Anëtarëve ka organizuar 3 (tre) mbledhje, ndërsa Bordi Mbikëqyrës ka zhvilluar 4 (katër) mbledhje.
- ▶ Aktiviteti kryesor ishte forumi “Digjitalizimi kundër parasë Cash”. Më pas u hartua një concept note dhe iu dërgua Kryeministrit, Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Guvernatorit.
- ▶ Komiteti Kombëtar për Sistemin e Pagesave shprehu dakordësimin për kanalin alternativ të pagesave (pagesë e menjëhershme).
- ▶ Përgatitja e studimit të dytë me temë “Besimi dhe perceptimi i konsumatorëve të bankat dhe sektori bankar” dhe publikimi i raportit të studimit në media, në dhjetor të vitit 2022.
- ▶ Trajtimi i projektit të digjitalizimit të pagesës së shërbimeve publike të ofruara nga e-Albania.
- ▶ Vendimi i Gjykatës së Lartë për miratimin e udhëzimit të ri për tarifat e përmbaruesve.
- ▶ Ngritja e Task Forcës së Emergjencave Kibernetike, e cila është një strukturë e përkohshme në varësinë e AAB-së përgjegjëse për trajtimin e çështjeve urgjente në lidhje me sigurinë kibernetike.
- ▶ 8 (tetë) seminare të organizuara dhe të realizuara në bashkëpunim me institucionet shtetërore dhe partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë.
- ▶ Vendimi i Asamblesë së Anëtarëve për heqjen e tarifave për transfertat bankare në Ukrainë.

▶ 3 (tre) tryeza të rrumbullakëta (2 me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP) dhe 1 me Ministrin e Financave dhe Ekonomisë për të diskutuar mbi skemën e Garancisë Sovrane të ndërmarrë nga Qeveria).

▶ 16 (gjashtëmbëdhjetë) kurse trajnimi për sektorin bankar, të realizuara në bashkëpunim me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë ku u trajnuan 287 punonjës nga bankat anëtare.

▶ Takime vjetore të Kryetarit të AAB-së me gazetarë të fushës së ekonomisë të transmetuara në mediat dhe portalet kryesore në vend.

▶ Iniciativat për përfshirjen financiare dhe edukimin financiar: organizimi i aktiviteteve të Javës së Parasë së bashku me Bankën e Shqipërisë.

▶ Organizimi online i Kuizit të Parave, me pjesëmarrjen e 360 fëmijëve të moshës 13-15 vjeç, nga 58 shkolla 9-vjeçare.

▶ Udhëtim me gazetarët e fushës së ekonomisë në kuadrin e edukimit financiar.

▶ Prezantimi i librit "Hapat e parë në financë". Publikimi i versionit elektronik. Projekti u sponsorizua nga "Finance in Motion" dhe AAB.

▶ Prezencë aktive në media.

▶ Publikime periodike të buletineve mujore, të dhënave të ndryshme, të raporteve vjetore (raporti i AAB-së dhe CSR) dhe statistikave për përdorim të brendshëm.

# 5. FAKTE DHE SHIFRA PËR 2022 - SEKTORI BANKAR NË SHQIPËRI

## Gjatë vitit 2022... \*

...Struktura e sistemit bankar ka ndryshuar; numri i bankave ka rënë në 11 dhe është rritur edhe numri i bankave me kapital shqiptar. Sektori bankar shfaqet i qëndrueshëm ndaj goditjeve me bazë rreziqet e kontrolluara. Viti 2022 u përmbyll me një rezultat financiar pozitiv, një nivel të mirë të kapitalizimit të aktivitetit dhe tregues të përmirësuar të cilësisë së kredisë..."



Në janar u bë funksional sistemi i pagesave AIPS EURO, i cili u jep mundësinë qytetarëve shqiptarë që të kryejnë pagesat e brendshme në monedhën euro me kosto më të ulëta dhe në një kohë më të shkurtër.



Në bashkëpunim me Bankën Botërore, autoritetet lokale dhe aktorët e tregut, u përgatit "Strategjia Kombëtare për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare" që synon të rrisë nivelin e kulturës dhe të përfshirjes financiare të publikut të gjërë.

# 4.84%

Rritja ekonomike  
(INSTAT, vlerësim paraprak)

# 6.7%

Norma mesatare  
e inflacionit

**2.75%**

Norma bazë e interesit

**11**

Numri i bankave

**33.8%**

Raporti i pjesës së aktiveve të bankave me kapital shqiptar me aktivet e sektorit

**5%**

Raporti i kredive të këqija

**10.8%**

Shkalla e papunësisë

**63.3%**

Raporti i borxhit publik bruto kundrejt PBB-së

**1.4%**

Norma e interesit për depozitat me afat në lekë në tremujorin e katërt

**8.0%**

Interesi i kredisë për artikuj me pakicë në lekë në tremujorin e katërt

**7.0%**

Interesi i kredisë mesatare të biznesit në lekë në tremujorin e katërt

**10.6%**

Rritje e nivelit të kredisë për sektorin privat

**10.4%**

Rritje e depozitave

**17%**

Rritje e nivelit të kredisë për  
banesa për individë

**69%**

Raporti i depozitave  
kundrejt PBB-së

**30.9%**

Raporti i kredive  
kundrejt PBB-së

**18%**

Raporti i mjaftueshmërisë  
së kapitalit

**212%**

Raporti i depozitave  
ndaj kredive

**87.9%**

Raporti i pjesës së aktiveve të  
sektorit bankar kundrejt PBB-së

**23.3**  
**miliardë lekë**

Fitimi i sektorit bankar

# 6. SHTYLLAT KRYESORE TË AAB-së

**Në këtë seksion përshkruhen pesë fushat që përbëjnë shtyllat kryesore të AAB-së.**

- ▶ **Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe bashkëpunimi me autoritetet**
- ▶ **Transformimi i sektorit bankar**
- ▶ **Trajnimi dhe zhvillimi i punonjësve të bankës**
- ▶ **Edukimi financiar**
- ▶ **Marrëdhëniet me publikun dhe komunikimet e brendshme dhe të jashtme**

## 6.1 Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe bashkëpunimi me autoritetet

### 6.1.1 Kuadri Ligjor dhe Nënligjor

Gjatë vitit 2022, sektori bankar nëpërmjet Zyrës Ekzekutive është përfshirë në procesin e konsultimit të disa projektligjeve dhe projektvendimeve të Këshillit të Ministrave, një pjesë e të cilëve më pas janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, apo nga autoritetet kompetente, p.sh.:

- Projektligji i ri "Për Agjencinë e Trajtimin të Garancive dhe Kredive të Këqija", në lidhje me të cilin përfaqësuesit e AAB-së kanë zhvilluar në sërë takime me përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të diskutuar shqetësimet dhe propozimet e bankave, të cilat në versionin e fundit të projektligjit janë marrë parasysh nga Ministria.
- Projektligji i ri "Për mbrojtjen e të dhënave", për të cilin përfaqësues të AAB-së kanë dhënë komentet dhe sugjerimet e tyre, si dhe kanë marrë pjesë në të gjitha takimet e zhvilluara gjatë procesit të konsultimit që ka të bëjë me këtë projektligj.
- Projektligji i ri "Për Amnistinë Fiskale dhe Penale". AAB-ja i bëri me dije Ministrisë shqetësimet e sektorit bankar, në veçanti: domosdoshmërinë e konsultimit të projektligjit në fjalë me institucionet ndërkombëtare (BE, FMN, BQE, Moneyval), nevojën për të pasur një dispozitë të qartë për përjashtimin ose jo nga detyrimet e ligjit për AML-në dhe FTF-në.
- Projektligji i ri "Për tatimin mbi të ardhurat", në të cilin AAB është përfshirë gjerësisht gjatë procesit të konsultimit.
- Projektligji "Për disa shtesa dhe një ndryshim në ligjin "Për inspektimin e punës".
- Projektligji "Për fondet private të pensioneve", i cili synon përmirësimin e bazës ligjore në tregun e fondeve private të pensioneve me kontribute të përcaktuara, si dhe harmonizimin me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare. Nëpërmjet AAB-së, sektori bankar ka paraqitur komente dhe sugjerime pranë autoritetit përgjegjës.
- Projektudhëzimi "Për mënyrat dhe procedurat e raportimit dhe marrjes së masave parandaluese nga organet ligjzbatuese "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", ku përshkruheshin të gjitha shqetësimet e bankave lidhur me identifikimin elektronik.

- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për metodat, procedurat e raportimit dhe masat parandaluese të nevojshme nga subjektet e përfshira në veprimtari financiare".
- Projekt rregullorja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare "Për kryerjen e veprimtarisë operacionale të shoqërive të brokerimit dhe bankave që ofrojnë shërbime investimi".
- Projekt rregullorja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri "Për disa ndryshime në Rregulloren nr. 197, datë 29.12.2020 "Për vlerësimin e përshtatshmërisë së klientit"".

## 6.1.2 Kuadri rregullator i Bankës së Shqipërisë

Shoqata Shqiptare e Bankave është angazhuar gjerësisht dhe ka bashkëpunuar ngushtë me Bankën e Shqipërisë përgjatë 2022.

- Projekt rregullorja "Për raportimin e të dhënave, identifikimin dhe monitorimin e treguesve për kreditimin dhe investimet në pasuri të paluajtshme", për të cilën AAB-ja ka dërguar të gjitha komentet dhe shqetësimet e sektorit bankar në lidhje me projekt rregulloren.
- Rregullorja "Për autentifikimin e thelluar të klientit dhe standardet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit", e cila synon të përcaktojë kriteret për ofruesit e shërbimeve të pagesave, të zbatojë masat e sigurisë për zbatimin e procedurës së autentifikimit të thelluar të klientit; përjashtimin nga zbatimi i kriterëve të sigurisë të autentifikimit të thelluar të klientit, bazuar te niveli i rrezikut, shumën dhe përsëritjen e transaksioneve të pagesave dhe kanaleve të pagesave të përdorura për ekzekutimin e tij; mbrojtjen e konfidencialitetit dhe integritetit të kredencialeve të personalizuar të sigurisë së përdoruesit të shërbimit të pagesave, krijimin e standardeve të përbashkëta, të hapura dhe të sigurta për komunikimin ndërmjet ofruesve të ndryshëm të shërbimeve të pagesave, pagesve dhe personave që marrin pagesën mbi ofrimin dhe përdorimin e shërbimeve të pagesave për zbatimin e Titullit IV të ligjit "Për shërbimet e pagesave".

## 6.1.3 Bashkëpunimi me autoritetet

### Për fiskalizimin

Sfidat kryesore me të cilat përballen bankat gjatë zbatimit të procesit të fiskalizimit si tatimpagues dhe raportues të faturave elektronike u shoqëruan me takime në kuadër të diskutimeve midis bankave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT). Duke marrë parasysh afatin e datës 30 qershor 2022, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve iu bënë të ditura shqetësimet e bankave (ato që kanë të bëjnë me bankën si tatimpagues apo ato që kanë të bëjnë me raportimin).

### Taksimi i eurobondeve

Taksimi i eurobondeve ishte një nga çështjet që u soll në vëmendjen e autoriteteve gjatë këtij viti. Pas marrjes së përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ndaj shkresës së dërguar në dhjetor të vitit 2021, sipas së cilës mbajtësit e këtyre titujve duhet të paguajnë taksa sipas interpretimit të kuadrit ligjor për taksimin, më datë 16 shkurt 2022, Zyra Ekzekutive e AAB-së i përcolli një shkresë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në vëmendje të Ministrit dhe për dijeni Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ku kërkonte deklaratën e ministrit për këtë çështje, duke theksuar se qëllimi i ligjit, siç përcaktohet nga Ministri, është përjashtimi i mbajtësve të titujve nga të gjitha taksat për emetimin e eurobonove të vitit 2021 si dhe për eurobonot e pamaturuara dhe për të cilat zbatohet i njëjti nen.

### Shmangia e Taksimit të Dyfishtë

Problemet e hasura në praktikë për zbatimin e taksimit të dyfishtë dhe trajtimin kontabël të fitimit dhe humbjeve të kapitalit të përcaktuar në titujt e shitur janë dy çështje të ngritura nga Komiteti i Financës dhe Kontabilitetit. Pas diskutimeve dhe marrjes së pëlqimit nga anëtarët, Zyra Ekzekutive e AAB-së ia bëri të ditur zyrtarisht këto shqetësime Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Bankës së Shqipërisë. U kërkua që ndryshimet e nevojshme dhe rishikimi i udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë të harmonizonin procedurat me praktikën më të mira bashkëkohore.

### Mbi trajtimin kontabël të fitimeve dhe humbjeve të kapitalit të përcaktuar për titujt e disponueshme për shitje (AFS)

AAB-ja i dërgoi një propozim Bankës së Shqipërisë për miratimin e standardit SNRF me kushtin që fitimet dhe humbjet nga AFS-të të mos merren parasysh në llogaritjen e kapitalit rregullator gjatë periudhës kalimtare, derisa autoriteti të kalojë në SNRF për mbikëqyrje. Komiteti i Financës dhe Kontabilitetit të AAB-së e trajtoi këtë çështje gjatë vitit në fjalë.





### **Për Procedurat e Prokurimit Publik**

Sektori bankar shprehu shqetësimet e tij në kuadër të respektimit të parimit të mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë në treg. Në këtë kontekst, më datë 4 mars 2022, Zyra Ekzekutive e AAB-së i dërgoi një shkresë Kryeministrit, z. Edi Rama, dhe për dijeni Guvernatorit dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, pasi disa praktika të ndjekura nga disa autoritete/subjekte të prokurimit për përcaktimin e kriterëve të kualifikimit të ofertuesve parashikojnë kushtin e paraqitjes së garancisë nga një institucion financiar me vlerësim A3, sipas agjencisë Moody's.

Më 23 mars 2022, Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i është përgjigjur shkresës së AAB-së, dhe ndër të tjera, deklaroi se vetë ligji për Prokurimin Publik nuk parashikon të drejtën e Autoriteteve Kontraktore për të përcaktuar një kërkesë të tillë në dokumentin e prokurimit. Për këto arsye, sipas APP-së, nuk ka një procedurë të ngjashme.

### **Për zbatimin e ndryshimeve në Rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja".**

Më datë 10 mars, Zyra Ekzekutive e AAB-së i kërkoi Bankës së Shqipërisë të bëjë interpretimin e saj për zbatimin e ndryshimeve të bëra në Rregulloren "Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja" në lidhje me dispozitat për ristrukturimin.

Sipas përgjigjes së Bankës së Shqipërisë, më datë 10 mars, Autoriteti i Mbikëqyrjes sqaroi se ndryshimet e bëra në nenin 13 të Rregullores (në lidhje me ristrukturimin e kredisë), që kanë hyrë në fuqi në datën 01.01.2022, do të zbatohen vetëm për kreditë e ristrukturuara nga data 01.01.2022 e në vazhdim.

### **Mbi urdhërin e përmbauesit privat**

Më datë 5 prill 2022, Zyra Ekzekutive e AAB-së i dërgoi një shkresë Guvernatorit duke ngritur çështjen e numrit të konsiderueshëm të urdhrave të përmbauesit privat. Në këtë shkresë është kërkuar gjithashtu që të merren parasysh shqetësimet e bankave në këtë drejtim, si dhe të ndërmerren nismat e nevojshme për ndryshimet në rregulloren e BSH-së "Për ekzekutimin e detyrimeve për shumatat e llogarive në bankë".

Më 17 qershor 2022, me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë, Zyra Ekzekutive e AAB-së ka dhënë informacion për përmbauesit specifikë privatë. Kërkesa e Ministrisë ka ardhur në përgjigje të shkresës së AAB-së drejtuar institucionit që sjell të gjitha shqetësimet e sektorit bankar.

Në datën 14 nëntor, Zyra Ekzekutive e AAB-së, me anë të një shkrese drejtuar Ministrit të Drejtësisë dhe për dijeni Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, solli në vëmendje shqetësimet përkatëse të sektorit bankar. Shkresa ishte një rikujtesë për dy shkresat e mëparshme të dërguara për këtë çështje, si dhe një kërkesë drejtuar Ministrit për të bërë ndërhyrjet e nevojshme me strukturat përkatëse të ministrisë.

## **6.2 Transformimi bankar**

### **Për Regjistrin Qendror të Llogarive Bankare**

Shqetësimi i bankës u shtua për shkak të numrit të konsiderueshëm të institucioneve që kërkonin informacion për klientët e bankave. Më 3 shkurt 2022, me anë të një shkrese zyrtare, Zyra Ekzekutive e AAB-së i ka drejtuar një shkresë për këtë çështje Ministrit të Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, dhe për dijeni të gjitha institucioneve me qasje të drejtpërdrejtë në regjistër dhe atyre që kanë të drejtë të paraqesin kërkesën. Zbatimi i ligjit "Për regjistrin qendror të llogarive bankare" kërkon që çdo kërkesë për informacion nëse një person ka një llogari bankare duhet të nxirret nga regjistri i llogarive. Pas identifikimit të llogarisë bankare, kërkesa për bllokim duhet t'i drejtohet vetëm bankës ku ndodhet llogaria përkatëse (jo të gjitha bankave).

Gjithashtu, çështja është trajtuar edhe në Këshillin e Investimeve, i cili është përfshirë në listën e rekomandimeve të konsoliduara për përmirësimin e klimës së investimeve, të hartuar nga MFE-ja. AAB-ja ka qenë në pritje të harmonizimit të kuadrit ligjor shqiptar për të bërë ndryshimet e nevojshme në ligjet organike të këtyre institucioneve.

Më 9 mars 2022, Zyra Ekzekutive e AAB-së, me anë të një shkrese zyrtare drejtuar Kryetarit të Bashkisë së Tiranës z. Erion Veliaj dhe për dijeni Zv. Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ka kërkuar zbatimin e ligjit "Për regjistrin e llogarive bankare" nga Drejtoria Rajonale e Taksave dhe Tarifave Vendore. Është kërkuar që kjo drejtori të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar qasje të drejtpërdrejtë në këtë regjistër, pra urdhrat e bllokimit të tyre të dërgohen vetëm te bankat, klientët e të cilave janë tatimpaguesit.

## Digjitalizimi i pagesës së shërbimeve publike të ofruara nga e-Albania

Qeveria po përpiqet të digjitalizojë pagesat si pjesë e politikave të përfshirjes financiare, pasi mendohet gjerësisht se digjitalizimi kontribuon në mënyrë indirekte në rritjen e mëtejshme ekonomike dhe reduktimin e informalitetit. Portali i qeverisë e-Albania ofron 95% të shërbimeve publike, të cilat mund të ofrohen plotësisht online që nga maji i vitit 2022. Megjithatë, për disa nga këto shërbime, baza ligjore kërkon që pagesa të bëhet online për shoqërinë e ofruesit të shërbimit, si pjesë e procesit të ofrimit të shërbimit. Përdorimi i portalit e-Albania që ofron shumë shërbime qeveritare, lehtëson dhe thjeshton komunikimin dhe ndërveprimin si të qytetarëve ashtu edhe të bizneseve me institucionet shtetërore.

Më 4 maj 2022, u zhvillua një takim në nivel teknik me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE) me përfaqësuesit e bankave, Bankës së Shqipërisë, Ministrisë dhe AKSHI-t. Pjesëmarrësit u angazhuan në një analizë të plotë të situatës, mundësive, problemeve dhe zgjidhjeve për të mundësuar kryerjen e pagesave online nga qytetarët.

Më 6 maj 2022, Kryeministri z. Rama zhvilloi një takim me drejtorët e përgjithshëm të sektorit bankar, ku u bëri thirrje që t'i bashkohen përpjekjes së përbashkët për të transformuar shërbimet bankare që ofrohen për qytetarët në të gjitha bankat tregtare që operojnë në Shqipëri. U bë e ditur se ishte ngritur një ekip i përbashkët pune mes qeverisë dhe Bankës së Shqipërisë për të punuar në këtë aspekt.

Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka e Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave dhe AKSHI, u krijua një grup pune i përbërë nga përfaqësues të secilës palë dhe i kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, z. Spiro Brumbulli me qëllim zbatimin e këtij Memorandumi.

Në kuadër të projektit, gjatë muajve në vijim u zhvilluan disa takime për të diskutuar fluksin e përgjithshëm të pagesave të shërbimeve publike nëpërmjet e-Albania dhe për të kërkuar zgjidhje për disa probleme të identifikuar. Bankat, si pjesë e projektit për digjitalizimin e pagesave të shërbimeve publike të ofruara nga e-Albania, ofruan një alternativë për të lehtësuar pagesën nëpërmjet e-banking. Në vijim të takimeve, dokumenti i miratuar nga Grupi i Punës u nënshkrua nga të gjitha institucionet përpara fazës së zbatimit të projektit.

### *Për këtë çështje janë organizuar disa takime:*

- Më datë 1 qershor 2022 – takim i drejtuar nga znj. Adela Xhemali, Zëvendës Ministre e Financave dhe Ekonomisë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), Bankës së Shqipërisë, MFE-së, AKSHI-t dhe bankave. Gjatë këtij takimi u prezantua mënyra si mund të kryhen transaksionet.
- Më datë 22 gusht 2022 – takim i drejtuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), znj. Delina Ibrahimaj, ku të pranishmit u njoftuan se autoriteti miratoi propozimin e bankave për mënyrën si mund të kryhen transaksionet dhe më tej do të ngrihej një grup pune.
- Takimet e grupit të punës.



## 6.2.1 Seminare dhe webinar-e



### Forumi "Digjitalizimi kundrejt parasë Cash"

Forumi u zhvillua në Tiranë më datë 14 qershor 2022. Ai mbledhi së bashku drejtues bankash, punonjës të industrisë bankare, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe publike, shoqata biznesi, staf akademik, media, politikanë, institucione ndërkombëtare dhe institucione të huaja. Gjithashtu, në forum mori pjesë Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Shtetit për Programin e Rindërtimit dhe Reformës, z. Arben Ahmetaj, Ministrija e Financave dhe Ekonomisë znj. Delina Ibrahimaj, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, dhe Kryetari i Komitetit të Ekonomisë dhe Financave në Kuvendin e Shqipërisë, z. Eduard Shalsi.

### Forumi u fokusua në tre çështje kryesore:

#### 1. Kanalet alternative të pagesës

Për sa i përket kanaleve alternative të pagesave, Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave ka miratuar një strategji për pagesat me vlerë të ulët, megjithatë nuk është zbatuar ende asnjë iniciativë apo projekt specifik. Në ditët e sotme, konsumatori dhe bizneset shqiptare janë përballur me të vetmen alternativë që është pranuar gjerësisht për pagesën e mallrave dhe shërbimeve, me para cash. Në raste të veçanta, veçanërisht në zona më të zhvilluara dhe njësi të qëndrueshme biznesi, mund të bëhen edhe pagesat me kartë. AAB po kërkon një alternativë tjetër me kosto të ulët dhe me përdorim të gjerë, për të cilën është rënë dakord nga komuniteti i biznesit, që të ekzistojë krahas parave cash. Forumi la hapësirë për përgatitjen e një concept note për të analizuar çdo mundësi për t'u fokusuar te një kanal alternativ pagesash.





**2. Reduktimi i përdorimit të parave cash dhe lufta kundër informalitetit**

Kanali alternativ i pagesave bëhet i domosdoshëm kur bëhet fjalë për sasinë e parave cash që qarkullojnë në ekonominë shqiptare. Për të reduktuar transaksionet në para cash, klientët dhe bizneset duhet të njihen me mundësi reale, të prekshme dhe lehtësisht të arritshme për të kaluar te pagesat elektronike. Reduktimi i parave fizike (cash) kursen kostot e printimit dhe mirëmbajtjes së parave, ndihmon në formalizimin e ekonomisë së vendit, si dhe përmirëson reputacionin e vendit.

Për të reduktuar përdorimin e parave cash, qeveria duhet të marrë në konsideratë vendosjen e një kufiri maksimal për pagesat cash për individët dhe mundësisht të unifikojë kufirin maksimal me atë të bizneseve.

**3. Përdorimi i portalit e-Albania nga bankat**

Digjitalizimi është një proces i thellë dhe i gjerë. Në teori, ky proces duhet të përfshijë të gjitha shërbimet dhe pagesat, si për sektorin privat ashtu edhe për atë publik. Në këtë kuadër, Forumi theksoi nevojën për të pasur një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bankës së Shqipërisë, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe AAB-së për ngritjen e një grupi pune për të gjetur një zgjidhje për kënaqësinë e të gjitha palëve të interesit për pagesat e shërbimeve publike të ofruara nga e-Albania. Ndoshta në mbledhjen e radhës të grupit të punës do të arrihet një marrëveshje për një zgjidhje të tillë të pritshme.

Duke iu tërhequr vëmendjen institucioneve përgjegjëse dhe aktorëve të tregut me fokus të veçantë të digjitalizimi i shërbimeve bankare, ky Forum shërbeu si një tryezë diskutimi për prezantimin e çdo mundësie të qëndrueshme, analizave të gjera, sfidave të pritshme, përvojave dhe objektivave në të ardhmen. Për këto arsye, u hartua një concept note, i cili iu paraqit strukturave shtetërore dhe palëve të interesuara përkatëse.




### Seminar: Zhvillimet fiskale dhe ligjore

Më 23 shkurt 2022, AAB dhe PwC Shqipëri dhe Kosovë organizuan një seminar të përshtatur me fokus të veçantë të "Zhvillimet fiskale dhe ligjore". Ky seminar u prezantoi pjesëmarrësve nga bankat aspekte të rëndësishme të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe transferimit të çmimit në sektorin bankar, implikimet fiskale të kuadrit të ri ligjor për eurobondet, rëndësinë e nënshkrimit elektronik për bizneset, problemet administrative për taksimin e dyfishtë dhe evazionin fiskal, përditësimet e pritshme në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me standardet evropiane, etj.



### Seminar mbi rritjen e ndërgjegjësimit të përfaqësuesve të bankave të nivelit të dytë duke u fokusuar te procedurat jashtë gjykatës

Seminari virtual u organizua më datë 24 shkurt 2022 dhe kishte në fokus rritjen e ndërgjegjësimit të bankave në Shqipëri për procedurën e përshtetur të riorganizimit, në përputhje me aktin nënligjor për marrëveshjen e ristrukturimit jashtë gjykatës, të miratuar në kuadër të ligjit të falimentimit dhe prezantimin e Udhëzuesit "Për praktikën dhe procedurat jashtë gjykatës" të hartuar në kuadër të projektit. Në seminar morën pjesë 23 përfaqësues të bankave.



### e-KYC dhe nënshkrimi elektronik – zgjidhje për institucionet financiare

Më datë 20 maj 2022, përfaqësuesit e bankave nga Shqipëria dhe Kosova u ftuan të merrnin pjesë në tryezën e rrumbullakët "e-KYC dhe nënshkrimi elektronik – zgjidhje për institucionet financiare", i cili u organizua nga Mellon Group dhe Euronovate dhe u mundësua nga AAB-ja. Eventu u fokusua te transformimi digjital që përfshin njohjen me standardet dhe përvojat më të avancuara teknologjike në Shqipëri, Kosovë dhe më gjerë.



### Eventi SWIFT Go

Më 20 shtator 2022, AAB-ja bashkëpunoi me SWIFT dhe CIS për të organizuar eventin SWIFT Go. SWIFT Go është një shërbim ndërbankar i dedikuar për transaksione ndërkufitare me vlerë të ulët. Folësit prezantuan shërbimin dhe ndanë lajmet më të fundit me pjesëmarrësit. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të të gjitha bankave anëtare.



### Trajnim për ngritjen e kapaciteteve për procedurat e falimentimit

Në vijim të trajnimeve dhe takimeve për procedurat e falimentimit, më datë 27 shtator 2022, AAB-ja dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) organizuan një trajnim për ngritjen dhe rritjen e kapaciteteve të stafit të bankave të nivelit të dytë për procedurat e falimentimit. Trajnimi, ku morën pjesë 22 përfaqësues të bankave anëtare të AAB-së, u fokusua te faza e dytë e Projektit të Zgjidhjes së Borxhit dhe procedurat e falimentimit në lidhje me bankat e nivelit të dytë.



### Seminari i Komitetit të Auditimit të AAB-së

Më datë 14 tetor 2022 u organizua seminari për anëtarët e Komitetit të Auditimit të AAB-së. Kryetari i Komitetit, z. Ilir Rudi, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Brendshëm në ABI Bank dhe znj. Ediola Biçaku, Drejtore e Departamentit të Auditimit të Brendshëm në Intesa Sanpaolo Bank Albania, ndanë pikëpamjet dhe përvojat e tyre me të pranishmit se si të ndërveprojnë dhe komunikojnë me linjat dhe funksionet e rrezikut dhe pajtueshmërisë në bankat e tyre. Znj. Dorida Stambolla, Drejtore e Departamentit të Auditimit të Brendshëm në Raiffeisen Bank ndau me pjesëmarrësit rishikimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm (IPPF) të përgatitur nga Global IIA. Për më tepër, u diskutuan dhe shtjelluar gjerësisht sfidat e hasura në fushën e auditimit të brendshëm. Temat e rendit të ditës nxitën diskutime të frytshme dhe zgjuan interesin e të gjithë pjesëmarrësve.



### Trajnim për Marrëveshjet e Lehtësimit të rregulluara nga Ligji Anglez

Më datë 26 tetor 2022, AAB-ja bashkëpunoi me Deloitte Legal për trajnimin "Marrëveshjet e lehtësimit të rregulluara nga Ligji Anglez dhe dokumentet financiare – Problemet dhe Opinionet". Trajnimi u fokusua te Marrëveshjet e Lehtësimit të rregulluara nga Ligji Anglez dhe te dokumente të tjera financiare që shpesh rregullohen nga Ligji Anglez (për shembull, letrat e garancisë), dhe u ndoq nga 14 përfaqësues të bankave.



### Financimi në sektorin e bujqësisë

Më 9 nëntor 2022, AAB-ja organizoi një takim me Bankën Botërore së bashku me përfaqësuesit e bankave. Ky takim u fokusua në aspekte të ndryshme se si i sheh sektori bankar problemet e identifikuara dhe masat e propozuara për stimulimin e financimit në sektorin e bujqësisë.

Në vijim të takimit, më datë 10 nëntor 2022, bankat morën pjesë në një seminar mbi financimin në sektorin e bujqësisë, i organizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Banka Botërore. Gjetjet dhe rekomandimet u prezantuan para një auditori më të gjerë, të përbërë nga përfaqësues nga institucionet shtetërore, sektori i bujqësisë dhe sektori financiar.

### Mundësitë e Financimit të Qëndrueshëm – takim me IFC-në

"Maksimizimi i Mundësive të Financimit të Qëndrueshëm" ishte tema e takimit të punës të organizuar në mëngjesin e datës 15 nëntor 2022, nga Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) në bashkëpunim të ngushtë me AAB-në dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bankave. Përfaqësuesit e IFC-së prezantuan elementët kryesorë të financimit të qëndrueshëm, i cili do të rrisë kapacitetet e institucioneve financiare për të zhvilluar klimën e biznesit në përputhje me udhëzimet e BE-së dhe ato globale.



### Seminaret për Financat e Gjelbra

AAB bashkëpunoi me German Sparkassenstiftung për organizimin e dy seminareve për Financat e Gjelbra, ku morën pjesë 56 përfaqësues të bankave.

- Seminari i parë me titull "Financat e Gjelbra, Rregullimi dhe Rreziku" u organizua më datë 7 dhjetor, i personalizuar për stafin drejtues të sektorit financiar.
- Seminari i dytë "Lundrimi drejt Financave të Gjelbra – Radari i Rrezikut ESG dhe Busulla e Financave të Gjelbra" u zhvillua më datë 15 dhjetor dhe iu kushtua stafit operacional të sektorit financiar që punon çdo ditë për zbutjen e rreziqeve dhe tani duhet të trajtojë rreziqet e ndryshimeve klimatike dhe zbutjen e tyre.



### 6.3 Trajnimi dhe zhvillimi i punonjësve të bankës

AAB është burimi më i gjerë i trajnimit për profesionistët e bankave. Nën koordinimin e AAB-së, gjatë vitit 2022 janë realizuar lloje të ndryshme trajnimesh:

- u zhvilluan trajnime në mbi **15** tema të ndryshme;
- u trajnuan mbi **287** punonjës të bankave;
- në bashkëpunim me **5** partnerë.

**Tema:** Të udhëheqësh me inteligjencë emocionale  
**Data:** 6-17 shkurt 2022  
**Partnerë:** Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)  
**Pjesëmarrja** 14 pjesëmarrës

**Përshkrimi:** Ky kurs trajnimi u ofroi pjesëmarrësve njohuri të thella dhe aftësi praktike, për të cilat kishin nevojë. Për më tepër, pjesëmarrësit mësuhan si të përdornin inteligjencën emocionale në situata të veçanta drejtimi, në mënyrë që të fitojnë autoritet dhe të kenë suksesin që pretendojnë si drejtues.

**Tema:** Suksesi në negociata përmes profesionalizmit  
**Data:** 28 shkurt dhe 1 mars 2022  
**Partnerë:** Network Tribe  
**Pjesëmarrja** 10 pjesëmarrës

**Përshkrimi:** Në këtë program, pjesëmarrësit mësuhan si të jenë të suksesshëm si negociator dhe të krijojnë vlera për veten dhe organizatën e tyre.

**Tema:** Analitika vizuale e të dhënave  
**Data:** 9-11 mars 2022  
**Partnerë:** ATTF / Qendra e Trajnimeve, Luksemburg  
**Pjesëmarrja** 11 pjesëmarrës

**Përshkrimi:** Agjenda u fokusua në kuptimin e analitikës vizuale dhe arsye përse ajo rrit perceptimin njerëzor, ciklin e procesit të analizës së të dhënave vizuale dhe mënyrën e përcaktimit të problemeve në biznes që duhen zgjidhur.

**Tema:** Menaxhimi i njerëzve: Drejtimi në cilësinë e trajnerit  
**Data:** 16-18 mars 2022  
**Partnerë:** Inspirance Consulting  
**Pjesëmarrja** 16 pjesëmarrës

**Përshkrimi:** Objektivat e këtij kursi: pasja e një kuptimi më të mirë të mënyrës tuaj të menaxhimit; Përvetësimi i një roli dhe qëndrimi të një menaxheri si trajner për ekipin tuaj.





**Tema:** Menaxhimi i rrezikut: rreziku i kredisë  
**Partnerë:** ATTF / Qendra e Trajnimeve, Luksemburg  
**Data:** 5-8 prill 2022  
**Pjesëmarrja** 18 pjesëmarrës

**Përshkrimi:** Ky kurs u sigurua që pjesëmarrësit të kuptonin mirë rrezikun e kredisë dhe metodat për menaxhimin efektiv.

**Tema:** Të menduarit sipas dizajnit  
**Data:** 27 prill 2022  
**Partnerë:** Network Tribe  
**Pjesëmarrja** 14 pjesëmarrës

**Përshkrimi:** Trajnimi ishte përshtatur për bankat pjesëmarrëse dhe synonte të merrej me konceptet bazë.

**Tema:** Auditimi në distancë - Një prirje hibride në epokën e transformimit digjital

**Data:** 27-28 prill 2022  
**Partnerë:** Instituti Shqiptar i Auditorëve të Brendshëm (ISHAB)  
**Pjesëmarrja** 15 pjesëmarrës

**Përshkrimi:** Njohja e kërcënimeve dhe mundësive që lidhen me auditimin në distancë dhe menaxhimin e çështjeve të kryerjes së auditimit dhe diskutimit për detyrat e zgjedhura.

**Tema:** Programi Ekzekutiv Blockchain

**Data:** 5 maj 2022  
**Partnerë:** Network Tribe  
**Pjesëmarrja** 13 pjesëmarrës

**Përshkrimi:** Me në fokus çështjet kryesore të teknologjisë, biznesit, ekonomike dhe ligjore që lidhen me teknologjitë e përparuara të blockchain.

**Tema:** Transformimi Digjital dhe Fintech

**Data:** 9-11 dhe 16-18 maj 2022  
**Partnerë:** ATTF / Qendra e Trajnimeve, Luksemburg  
**Pjesëmarrja** 15 pjesëmarrës

**Përshkrimi:** Ky kurs ofroi një prezantim solid për kuadrot digjitale dhe të transformimit.



**Tema:** Procesi i Vlerësimit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit të Brendshëm (ICAAP)  
**Data:** 24-28 maj 2022  
**Partnerë:** ATTF / Qendra e Trajnimeve, Luksemburg  
**Pjesëmarrja** 25 pjesëmarrës  
**Përshkrimi:** Kursi ua shpjegoi në mënyrë të qartë ICAAP-në pjesëmarrësve si një komponent kyç të Rishikimit të Mbikëqyrjes dhe Procesit të Vlerësimit (SREP) në sektorin bankar.



**Tema:** Menaxhimi i sigurisë kibernetike dhe të informacionit  
**Data:** 13-16 dhe 20-23 qershor, 2022  
**Partnerë:** ATTF / Qendra e Trajnimeve, Luksemburg  
**Pjesëmarrja** 15 pjesëmarrës  
**Përshkrimi:** Programi kryesisht ofroi zgjidhje për çështjet që kanë të bëjnë me temën, të cilat drejtuan zgjedhjet dhe misionin e pjesëmarrësve, duke marrë parasysh rreziqet lidhur me sigurinë kibernetike. Në trajnim morën pjesë palë të interesit nga sektori bankar.



**Tema:** Navigimi në të panjohurën: Mënyra e re për të udhëhequr në botën e VUCA-D-D  
**Data:** 23-24 qershor 2022  
**Partnerë:** Instituti Austriak i Ekselencës (AIE)  
**Pjesëmarrja** 16 pjesëmarrës  
**Përshkrimi:** Ky trajnim u fokusua në zhvillimin e kompetencave dhe aftësisë si Lider i VUCADD.



**Tema:** Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML & CTF) - në nivel bazë  
**Data:** 12-14 shtator 2022  
**Partnerë:** ATTF/Qendra e Trajnimeve, Luksemburg  
**Pjesëmarrja** 14 pjesëmarrës  
**Përshkrimi:** Seminar interaktiv që ndërthur leksione, raste studimore dhe shkëmbime pikëpamjesh dhe përvojash. Pjesëmarrësit mësuuan të shqyrtojnë standardet evropiane dhe ligjet dhe rregulloret e Luksemburgut për AML/CTF, të kuptojnë konceptet e vigjilencës së duhur të thjeshtuar, vigjilencës normale dhe të zgjeruar, etj.



**Tema:** Navigimi në të panjohurën  
**Data:** 12-13 shtator 2022  
**Partnerë:** Instituti Austriak i Ekselencës (AIEEx)  
**Pjesëmarrja** 16 pjesëmarrës

**Përshkrimi:** Temat që mbulohen nga kursi: sistemi kompleks adaptiv (C.A.S.) – aplikimi i të menduarit sistematik në organizata; excel-i në mjedisin VUCADD me kuadrin Cynefin; drejtimi i një organizate mësimore; etj.

**Tema:** Shitja e shërbimeve financiare dhe menaxhimi i marrëdhënieve me klientët

**Data:** 19-21 shtator 2022  
**Partnerë:** ATTF/Qendra e Trajnimeve, Luksemburg  
**Pjesëmarrja** 16 pjesëmarrës

**Përshkrimi:** Kursi ua shpjegoi në mënyrë të qartë teknikat e shitjes pjesëmarrësve që synojnë të shesin shërbime dhe produkte të klientët dhe të menaxhojnë në mënyrë efektive marrëdhëniet me klientët.

**Tema:** Procesi i Vlerësimit të Mjaftueshmërisë së Likuiditetit të Brendshëm – ILAAP




**Data:** 20 tetor 2022  
**Partnerë:** ATTF/Qendra e Trajnimeve, Luksemburg  
**Pjesëmarrja** 34 pjesëmarrës

**Përshkrimi:** Ky kurs synoi t'u sigurojë pjesëmarrësve një përshkrim të plotë se si të zbatojnë një proces ILAAP, edhe në kuadrin e ndërveprimeve të Rishikimit të Mbikëqyrjes dhe Procesit të Vlerësimit (SREP) me administratorin e bankës.

**Tema:** Auditimi i TI-së dhe Roli i Auditimit të Brendshëm

**Data:** 1-2 dhjetor 2022  
**Partnerë:** Instituti Shqiptar i Auditorëve të Brendshëm (ISHAB)  
**Pjesëmarrja** 25 pjesëmarrës

**Përshkrimi:** Ky kurs është krijuar për Audituesit jo-TI të cilët kryejnë detyra bazë dhe e njohin përkufizimin e tyre si Qeverisja e TI-së (p.sh., Projektet e TI-së, Menaxhimi i Burimeve dhe Portofolit) ose Siguria e TI-së.



## 6.4 Edukimi Financiar

### Libri “Hapat e parë në financë” i përkthyer në gjuhën shqipe nga AAB-ja

Publikimi digjital “Hapat e parë në financë”, nga Gunnar Baldvinsson, një libër i vlerësuar në nivel ndërkombëtar për nevojat e fëmijëve, mësuesve dhe të rriturve për të mësuar konceptet bazë të financës, është botuar në gjuhën shqipe falë nismës së AAB-së. Botimi në nivel ndërkombëtar, i paraqitur nga Federata Evropiane e Bankave, kërkon të udhëzojë mësuesit në mbarë Evropën, të cilët janë në kërkim të ideve për mesimdhënien e edukimit financiar. Ky libër duhet të shërbejë si literaturë bazë për të gjithë nxënësit e klasës së nëntë që marrin pjesë çdo vit në Kuizin e Parasë, të organizuar nga AAB-ja. Botimi i këtij libri në gjuhën shqipe u mundësua me mbështetjen financiare të Fondit të Zhvillimit pranë Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE DF).

Aktiviteti i prezantimit u organizua më 9 shkurt 2022 dhe u zhvillua në ambientet e shkollës 9-vjeçare “Emin Duraku” në Tiranë. Përveç prezantimit, përfaqësuesit e AAB-së u dhanë nxënësve informacione për konkursin “Kuizi i Parasë”.



### Leksion i hapur

Më 8 shkurt 2022, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, z. Spiro Brumbulli, ishte i ftuar në forumin e organizuar nga Universiteti Evropian i Tiranës për të folur mbi “Kriptoalutat në tregun shqiptar” me studentët e ekselencës të programeve bachelor dhe master në Ekonomi dhe Financë.



## Nisma për edukimin financiar të brezit të ri

Më 7 qershor 2022, AAB iu bashkua German Sparkassenstiftung Albania për të mbajtur një leksion mbi rëndësinë e njohjes së parave dhe kursimeve. Ky projekt u organizua në shkollat fillore të Tiranës në bashkëpunim me BKT-në. Nxënësit patën mundësinë të luanin Lojën e Kursimeve dhe të kuptonin konceptet në mënyrë miqësore.

### Java e Parasë 2022

Në datat 21-27 mars 2022, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave, me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave, hapi Javën e Parasë 2022 nën sloganin "Tregohu i zgjuar me paranë, ndërto të ardhmen tënde!".

Java e Parasë 2022 solli së bashku në mënyrë aktive më shumë se 700 nxënës dhe 500 studentë.

Më 24 mars u mbajt ceremonia e hapjes së Javës Globale të Parasë, ku morën pjesë Guvernatori i Bankës së Shqipërisë (BSH), Ministri i Arsimit dhe Sportit, Kryetari i Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe drejtues të tjerë të lartë të bankave tregtare.

Pas fjalimeve, aktiviteti vijoi me shpërndarjen e çmimeve për fituesit e 4 konkurseve, të prezantuara më parë nga BSH-ja dhe AAB-ja:

- Konkursi "Vizatimi më i mirë" për klasën e tretë dhe të katërt. Ky konkurs u organizua me mbështetjen e Union Bank.
- Konkursi "Meme më e mirë" për nxënësit e klasës së 9-të. Ky konkurs u organizua me mbështetjen e OTP Bank Albania.
- Konkursi "Video më e mirë" për nxënësit e shkollave të mesme. Ky konkurs u organizua me mbështetjen e Credins Bank.
- Sfida e javës: 7 pyetje rreth parave dhe bankave për nxënësit e shkollave të mesme. Ky konkurs u organizua me mbështetjen e Raiffeisen Bank.
- Konkursi "Eseja më e mirë". Ky konkurs u organizua me mbështetjen e Bankës Kombëtare Tregtare (BKT)




### Kuizi i Parasë 2022

Më 30 mars, Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB), në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD), organizuan për të katërtën herë Kuizin e Parasë 2022. Ky konkurs është kthyer në një traditë të përvitshme dhe synon përmirësimin e njohurive financiare të fëmijëve dhe të rinjtë.

Në konkurs morën pjesë 360 fëmijë, nga moshën 13 deri në 15 vjeç, nga 58 shkolla 9-vjeçare. Ekipi fitues ishte shkolla "Hafiz Ali Podgorica" në Durrës.

Më 10 maj 2022, ekipe studentësh nga 29 vende të Evropës morën pjesë në finalen e Kuizit Evropian të Parasë, një konkurs ndërkombëtar i përvitshëm për edukimin financiar i organizuar nga Federata Evropiane e Bankave (EBF) që nga viti 2017. Shqipëria u përfaqësua nga ekipi fitues në rang kombëtar.



Më datë 12 prill 2022, Shoqata Shqiptare e Bankave, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe Agjencinë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave, organizuan ceremoninë e ndarjes së çmimeve për fituesit e Kuizit të Parasë ku fituesit e tre vendeve të para morën çmime nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Për më tepër, mësuesit e ekipeve fituese morën dhurata simbolike nga Banka e Shqipërisë.

### Leksione të hapura në universitete me temë: Të rinjtë dhe Bankingu Digjital

Në datat 24 dhe 25 mars, në bashkëpunim me bankat anëtare, AAB-ja organizoi leksione të hapura me temë "Të rinjtë dhe Bankingu Digjital". Përfaqësuesit e bankave rritën ndërgjegjësimin për rëndësinë e kulturës financiare si pjesë e edukimit të tyre të përgjithshëm. Gjatë leksioneve u prezantuan prioritetet që kanë bankat ndaj plotësimit të nevojave të klientëve përmes kanaleve digjitale.

Leksionet u organizuan në bashkëpunim me disa universitete:

- Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN)
- Universiteti Epoka
- Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës
- Universiteti Evropian i Tiranës
- Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH)
- Universiteti i Biznesit i Tiranës (TBU)
- Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkodër
- Universiteti Aleksandër Xhuvani, Elbasan.

### Leksione të hapura

- Më datë **18 mars 2022**, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, Dr. Spiro Brumbulli, organizoi një leksion të hapur mbi kryptoasetet. Në këtë leksion morën pjesë studentët e programit të studimit Bachelor, Fakulteti i Biznesit në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.
- Më datë **25 mars 2022**, Drejtori i Përgjithshëm i Intesa Sanpaolo Bank Albania, z. Alessandro D’Oria, së bashku me Drejtorin e Departamentit të Financës, z. Julian Çela, vizituan Universitetin Epoka në Tiranë. Pjesë e kësaj vizite ishte edhe prezantimi i një leksioni të hapur ku morën pjesë 100 studentë të Fakultetit të Shkencave të Ekonomisë dhe Administrimit me fokus buxhetin dhe pasqyrat financiare.
- Më **31 maj 2022**, AAB-ja organizoi një Leksion të Hapur në Universitetin Evropian të Tiranës (UET) ku morën pjesë studentë dhe pedagogë të Fakultetit të Financës dhe Ekonomisë në kuadër të bashkëpunimit të saj me stafin akademik në lidhje me edukimin financiar. AAB-ja u përfaqësua nga znj. Iva Ikonomi, Drejtore e Bankingut për Individë në Fibank Albania, e cila prezantoi një përmbledhje mbi rëndësinë e menaxhimit të parasë dhe veçanërisht të transparencës bankare.




## 6.5 Marrëdhëniet me Publikun dhe Komunikimet e Brendshme dhe të Jashtme

Aktivitetet tona, eventet, mbulimi mediatic dhe prodhimet e mediave sociale në vitin 2022 vazhduan të rrisin ndërgjegjësimin për tendencat bankare dhe të nxjerrin në pah rolin pozitiv që mund të luajë aktiviteti bankar në shoqëri.

Gjatë këtij viti, Kryetari i Bordit Mbikëqyrës dhe Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së u ftuan për të mbajtur fjalime apo për të marrë pjesë në aktivitete për të dhënë këndvështrime të ndryshme të rëndësishme për këtë sektor mbi ngjarjet kryesore aktuale. Përfaqësuesit e AAB-së vazhduan të paraqesin qëndrimin e AAB-së për çështjet që kanë të bëjnë me këtë sektor.

Për më tepër, u vu re një rritje e dukshme në intervistat në media, e cila nga 12 që ishte në 2021 u dyfishua në 28 në vitin 2022.

Është e rëndësishme të theksohet rritja e audiencës dhe arritjet tona online në vitin 2022, me një rritje prej 231 të trafikut të përdoruesve në faqen tonë zyrtare në Facebook dhe një rritje prej 72% në Instagram.



### Bankat hoqën dorë nga tarifat për transfertat bankare në Ukrainë

Më 4 mars 2022, AAB-ja njoftoi vendimin e bankave anëtare për të tarifuar zero komisione për transfertat e parave në Ukrainë dhe/ose përfituesit, qytetarë/individë dhe institucione shtetërore të Ukrainës. Kjo masë ofroi lehtësi për të gjithë personat që donin të kontribuonin dhe dërgonin para për institucionet shtetërore, organizatat e tjera jofitimprurëse, organizatat e bamirësisë dhe qytetarët ose grupet e qytetarëve në nevojë për të përballuar situatën e vështirë të krijuar pasi Rusia pushtoi Ukrainën



## 6.5.1 Aktivitetet me median

### Media dhe Edukimi Financiar: një prioritet për AAB-në

Komunikimi i AAB me gazetarët e fushës së ekonomisë është kthyer tashmë në traditë për të përfituar transparencën dhe cilësinë e informacionit publik. AAB-ja zhvillon takime të rregullta me gazetarë për të ofruar informacion mbi aktivitetin e saj, si pjesë e strategjisë së komunikimit mediatic. Gjatë vitit, Kryetari i AAB-së, z. Bledar Shella organizoi dy takime me gazetarët e fushës së ekonomisë të mediave dhe portaleve kryesore në vend:

- Më 15 shkurt 2022, gazetarëve iu komunikua një përmbledhje e performancës së bankave për vitin 2022. Prioritetet e AAB-së për vitin 2022 dhe rëndësia e rolit të medias në edukimin financiar dhe çështjet e digjitalizimit ishin ndër temat kryesore të diskutimit.



- Më 18 nëntor 2022, z. Shella prezantoi zhvillimet më të fundit në sektor, me fokus të veçantë efektin e rritjes së normave të interesit dhe ecurinë e kreditimit.



- Më 17-19 qershor 2022, AAB-ja, me mbështetjen e OTP Bank Albania, organizoi aktivitetin e përvitshëm me gazetarët e fushës së ekonomisë. Ky aktivitet kishte veçanërisht në fokus digjitalizimin. Tetëmbëdhjetë gazetarët e fushës së ekonomisë që morën pjesë në aktivitet patën mundësinë të njihen me problematikat kryesore të sektorit bankar dhe sfidat që i rrethojnë, si dhe të shohin nga afër zbatimin e disa praktikave më të mira të Grupit OTP në selinë e tyre në Hungari.





## 6.5.2. Pjesëmarrja në veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare

### Kreditimi dhe financimi i sektorit të bujqësisë në Shqipëri

Drejtorët e Përgjithshëm të bankave morën pjesë në aktivitetin "Kreditimi dhe financimi i Bujqësisë në Shqipëri", të organizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural më 26 janar 2022, me praninë e Kryeministrit të Shqipërisë, z. Edi Rama, Ministres së Financave dhe Ekonomisë, znj. Delina Ibrahimaj, dhe Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Genti Sejko. Ky takim u fokusua në nxitjen e diskutimeve për kreditimin e sektorit të bujqësisë në Shqipëri dhe prezantimin e nismës së Qeverisë Shqiptare për Programin e Mbështetjes së Agrobiznesit.

Kryetari i AAB-së, z. Bledar Shella foli në emër të Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB), duke përmendur disa nga faktorët që kanë penguar rritjen e kreditimit të bujqësisë. Ai theksoi nevojën për një bashkëpunim më të mirë të industrisë bankare me institucionet shtetërore për gjetjen e mekanizmave për uljen e rrezikut dhe lehtësimin e kreditimit të bujqësisë. Duke mbështetur skemën e garancisë së qeverisë me 1 miliardë lekë për bujqësinë, z. Shella theksoi vëmendjen që bankat i kushtojnë sektorit të bujqësisë.



### Mbledhja e Këshillit të Investimeve

Shtyllat e ndërhyrjes së qeverisë për përmirësimin e klimës së biznesit në vend dhe agjenda e Këshillit të Investimeve (KI) 2022 u diskutuan në mbledhjen plenare të mbajtur më 31 janar 2022, të kryesuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, znj. Delina Ibrahimaj. Mbledhja u organizua në një format hibrid dhe në të morën pjesë të gjithë anëtarët dhe partnerët e KI-së, duke përfshirë përfaqësues nga sektori publik dhe privat dhe agjencitë zhvillimore në rolin e vëzhguesve. Në mbledhje mori pjesë Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së.

### Instrumenti i garancisë nga IFC

Më 19 prill 2022, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MARD) të Shqipërisë dhe Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), pjesë e Grupit të Bankës Botërore, zhvilluan një takim për t'u prezantuar pjesëmarrësve zbatueshmërinë e mundshme të faturave të të mbjellave dhe të depove si instrumente efektive të financimit të bujqësisë në vend për të siguruar financimin e kapitalit qarkullues për sektorin e bujqësisë. Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së mori pjesë në këtë aktivitet dhe ndau me personat e pranishëm përvojën e bankave me fokus kreditimin e bujqësisë.

### Mbledhja e Këshillit të Agrobiznesit Bujqësor Shqiptar

AAB-ja mori pjesë në mbledhjen e organizuar nga Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar më 29 prill 2022. Gjatë këtij forumi u trajtua gjerësisht tema e bujqësisë, agroturizmit dhe mjedisit në zonat rurale. Në mbledhje morën pjesë ministrat e Bujqësisë dhe Mjedisit ndër vite, si dhe ministrat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, përfaqësues të fushave akademike, ekspertë, shoqata dhe përfaqësues të projekteve donatore.



### Takimi i Shoqatave të EBF-së

- Më 30 maj 2022, u organizua takimi i 53-të e Shoqatave të EBF-së. Në këtë takim, AAB-ja u përfaqësua nga Sekretari i saj i Përgjithshëm. Gjatë takimit, i cili ishte takimi i parë fizikisht që nga fundi i vitit 2019, ndër të tjera, u diskutuan tema të rëndësishme me zhvillimet e sektorit bankar dhe vendet anëtare përkatëse të asociuara. Z. Brumbulli informoi pjesëmarrësit për aktivitetet e zhvilluara nga AAB-ja duke filluar nga muaji janar e deri më tani. Ndikimi i luftës në Ukrainë, praktikatat më të mira për AML-në, rritja e qëndrueshme, Bazeli IV, edukimi financiar etj., ishin ndër temat më të diskutuara me interes të lartë.
- Takimi i 54-të i Anëtarëve të Asociuar të Federatës Evropiane të Bankave (EBF) u zhvillua më 22 shtator 2022, në Bruksel. Takimi përfshiu fjalime nga folës të ftuar të nivelit të lartë nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Gjithashtu, ai u fokusua në aktivitetet e EBF, zhvillimet më të fundit në nivel të BE-së, çështjet e inovacionit dhe sigurisë kibernetike dhe prioritetet e sektorit. Si pjesë e agjendës, u shtjellua gjerësisht paketa legjislative e BE-së për luftën kundër pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit (AML/CFT) dhe qëndrimi i EBF-së.

### Raporti i Diagnostikimit të Sektorit Privat të Vendit (CPSD)

Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) së bashku me Bankën Botërore (BB) hartuan Raportin e Diagnostikimit të Sektorit Privat të Vendit (CPSD) për të ofruar informacion të vlefshëm mbi sfidat dhe mundësitë në tre sektorë: turizëm, agrobiznes dhe industrinë e pjesëve të automjeteve dhe opsionet e politikave për të shfrytëzuar më mirë kontributin e sektorit privat në arritjen e objektivave për zhvillimin e Shqipërisë. Më 15 qershor 2022, u prezantuan gjetjet e raportit të CPSD-së dhe në aktivitet mori pjesë një përfaqësues i AAB-së.

### Raporti mbi metodologjinë e sektorit të OJQ-ve për vlerësimin e rreziqeve të financimit të terrorizmit

Më 17 qershor 2022, Partners Albania për Ndryshim dhe Zhvillim, organizoi një tryezë të rumbullakët mbi metodologjinë e vlerësimit të rrezikut të OJQ-ve për financimin e terrorizmit në vijim të përmbushjes së rekomandimeve të Task Forcës së Veprimit Financiar, perspektivës dhe rolit të institucioneve në këtë proces, planet e tyre për zbatimin e tij dhe lidhjen me Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut. Gjetjet përfshijnë të dhëna dhe informacione të marra nga institucionet shtetërore, sektori financiar, OJQ-të, komunitetet fetare dhe raportet ndërkombëtare. Të pranishëm në takim ishin përfaqësues të Njësisë së Inteligjencës Financiare, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Bankës së Shqipërisë dhe Zyrës Ekzekutive të AAB-së.

### Mbi vlerësimin e rrezikut kombëtar të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Seminari i organizuar më 20 qershor 2022, nga Këshilli i Evropës në bashkëpunim me FNJIF-në, prezantoi mjetet metodologjike për kryerjen e vlerësimit kombëtar të rrezikut kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit sipas metodologjisë përkatëse të Këshillit të Evropës. Përfaqësuesit e AAB-së kishin nderin të merrnin pjesë në këtë aktivitet.

### Marketingu digjital

Më 23 qershor 2022, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë (UCCIAL) organizoi trajnimin mbi Marketingun Digjital në kuadër të projektit "Mbështetja për Ballkanin Perëndimor 6 CIF". Në trajnim mori pjesë përfaqësuesi i AAB-së.



### Shoqata e Bankave të Kosovës përmylli Konferencën e parë Rajonale të AML/CFT 2022

Më 29 dhe 30 shtator 2022, Shoqata e Bankave të Kosovës organizoi Konferencën Rajonale të AML/CFT 2022 për Kosovën. Diskutimet u fokusuan në tema të perspektivës bankare dhe rregullatore, duke adresuar sfidat ndaj rregulloreve aktuale dhe të parashikuara të BE-së, si dhe implikimet e AML-së në epokën e transformimit digjital. Në konferencë morën pjesë edhe përfaqësues nga Shqipëria si Banka e Shqipërisë, Drejtorja e Përgjithshme Kundër Pastrimit të Parave dhe AAB-ja. Në konferencë mori pjesë Kryetari i Komitetit të Përputhshmërisë së AAB-së së bashku me Koordinatorin e Komitetit.

### Konferenca e 44-të e BACEE për bankat

Në tetor 2022, u organizua Konferenca e 44-të e BACEE për Bankat, një event hibrid që bëri së bashku më shumë se 300 të ftuar nga 32 shtete. Diskutimet në panel u fokusuan në pasqyrën e sektorit bankar të planeve makroekonomikë të vendeve të EQL/EJL në Evropë dhe çështje të tjera të rëndësishme. AAB-ja kishte nderin të merrte pjesë në këtë aktivitet.

### 20 vjetori i Shoqatës së Bankave të Kosovës

Më 3 nëntor 2022, kryetari i Bordit Mbikëqyrës të AAB-së dhe Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së morën pjesë në rastin e 20-vjetorit të themelimit të Shoqatës së Bankave të Kosovës (BQK).

Me rastin e 20 vjetorit të themelimit të BQK-së, u organizua dhe u festua në një event gala Konferenca Ndërkombëtare e Nivelit të Lartë "Rreziqet dhe mundësitë në një sektor financiar dinamik – rruga e zhvillimit". Aktiviteti bëri së bashku drejtues të lartë të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

### Kryetar i AAB-së në mbledhjen e VIII të Komitetit Kombëtar për Sistemin e Pagesave

Kryetari i AAB-së, z. Bledar Shella, mori pjesë në mbledhjen e tetë të Komitetit Kombëtar për Sistemin e Pagesave (KKSP), e cila u zhvillua më 9 nëntor 2022, në ambientet e Bankës së Shqipërisë. Në fjalimin e tij, z. Shella nxiti arritjet e deritanishme të tregut dhe projektet përkatëse të së ardhmes, dhe theksoi rëndësinë dhe prioritetet që industria bankare i kushton zhvillimit të shërbimit të pagesave, si një arritje e rëndësishme në procesin e digjitalizimit.



## 6.5.2 Publikimet

Në vitin 2022 u publikua botimi i fundit i **Revistës Bankieri**. Pastaj, AAB-ja vendosi të prezantojë një blog dhe ftoi të gjithë palët e interesit të kontribuojnë rregullisht dhe të postojnë çështje dhe tema bankare përkatëse. Blogu i ri Bankieri tani është në kohë reale dhe gjendet në faqen e internetit të AAB-së.

Broshura tremujore e **Përgjegjësisë Sociale të Korporatave (CSR)** është raporti i ri periodik i publikuar nga AAB-ja për të ndarë veprimet e përgjegjësisë sociale të korporatave dhe angazhimet e bankave. Tashmë broshura gjendet vetëm në version elektronik.

**Raportet vjetore të CSR: Bankat për Shoqërinë 2021**, shqip dhe anglisht, kopje elektronike dhe fizike.



Në faqen zyrtare të AAB-së u publikuan **statistikat**, konkretisht të dhënat e pa audituara të tremujorit për treguesit kryesorë të sistemit bankar sipas SNRF-ve, si dhe të dhënat agregate mujore për të gjithë sistemin.

Në vitin 2022, AAB-ja publikoi veçmas "Kartat dhe Bankingu nga Shtëpia" si tregues të rinj.

### Perceptimi dhe besimi i klientëve në bankat dhe sektorin bankar në Shqipëri- Prezantimi i gjetjeve të studimit

Në datën 21 dhjetor 2022 u organizua prezantimi i gjetjeve të studimit mbi besimin e klientëve në banka dhe në sektorin bankar. Ky studim i dytë, i cili kryhet tashmë nga AAB-j çdo tre vite, tregon perceptimin e klientëve të bankave dhe përvojën e tyre ndaj shërbimit të ofruar nga bankat, nivelin e besueshmërisë krahasuar me institucionet apo sektorët e tjerë, produktet dhe shërbimet bankare më të përdorura, përdorimin e kanaleve digjitale, transparencën etj. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të bankave, Bankës së Shqipërisë, AMF-së, institucioneve financiare jo-bankare, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, bashkëpunëtorëve të AAB-së dhe mediave.

Rezultatet e studimit vërtetuan sërish se sektori bankar është industria më e besueshme nga individët në krahasim me industrinë, institucionet dhe sektorët e tjerë.



### 6.5.3 Aktivitetet sociale

#### Takimi i Bordit Mbikëqyrës të AAB-së me Komitetet Teknikë

- Më 16 mars, 2022, Bordi Mbikëqyrës i AAB-së mbajti një takim me anëtarët e Komitetit të Financave dhe Kontabilitetit. Kryetari i AAB-së, z. Bledar Shella, vlerësoi angazhimin e anëtarëve të Komitetit, kontributin dhe mbështetjen e tyre në propozimet e bëra nga Zyra Ekzekutive, si dhe sigurimin e vazhdueshëm të të dhënave për aspekte të veçanta të veprimtarisë bankare. Theks i veçantë iu kushtua rolit vendimtar që ata luajnë në çështjet fiskale dhe standardet ndërkombëtare të raportimit.
- Më 18 tetor 2022, Bordi Mbikëqyrës i AAB-së organizoi një takim me anëtarët e Komitetit Ligjor. Në fokus të diskutimit ishte angazhimi dhe kontributi për çështjet e industrisë bankare dhe përmirësimi i mëtejshëm i marrëdhënieve ndërmjet komitetit teknik dhe Zyrës Ekzekutive të AAB-së.
- Gjatë vitit 2022, AAB-ja ka organizuar dhe ka marrë pjesë në diskutime dhe tryeza të përbashkëta me strukturat shtetërore dhe palët e interesit për digjitalizimin e shërbimeve financiare. Për të vlerësuar angazhimin dhe punën aktuale të bërë, më 23 nëntor 2022, anëtarët e Bordit Mbikëqyrës të AAB-ja organizuan një takim me anëtarët e Komitetit Ndihmës të Pagesave, Kartave, Digjitalizimit dhe Kanaleve Alternative, të cilët kanë qenë aktivë dhe mjaft të angazhuar në ndjekjen e këtyre çështjeve.



#### Takimi i fundvitit

Më 14 dhjetor 2022 është mbajtur takimi i Asamblesë së Anëtarëve të AAB-së, gjatë së cilit janë vlerësuar aktivitetet e Shoqatës gjatë vitit 2022 dhe është diskutuar dhe miratuar plani i biznesit dhe buxheti për vitin 2023. Në vijim të takimit, anëtarët së bashku me përfaqësues të bankave anëtare dhe kryetarë të komiteteve teknike të AAB-së, morën pjesë në Takimin e Fundvitit – eventin tradicional në fund të vitit, i organizuar zakonisht nga AAB-ja. Të ftuar nderi ishin Guvernatori, z. Gent Sejko dhe përfaqësues të tjerë të Bankës së Shqipërisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shqiptare të Sigurimit të Depozitave, z. Genci Mamani. Në fjalën e tij përshëndetëse të mbajtur me këtë rast, Kryetari i AAB-së dhe Drejtori i Përgjithshëm i OTP Bank Albania, z. Bledar Shella, vlerësoi arritjet e industrisë bankare dhe veprimtarinë e AAB-së dhe shprehu besimin e tij për sukses në vitin 2023.



## 7. KOMITETET TEKNIKE - AKTIVITETET DHE ARRITJET

Seksioni në vijim përmbledh çështjet kryesore të trajtuara nga komitetet teknike të AAB-së. Komitetet Teknike të AAB-së dhe Grupet e Punës u krijuan për të koordinuar çështje të caktuara dhe u mbledhën për të diskutuar dhe shkëmbyer përvojat dhe shqetësimet për çështjet operative dhe për ato legjislative, të cilat u ndoqën nga Zyra Ekzekutive e AAB-së gjatë gjithë vitit.

### Komiteti i Financës dhe Kontabilitetit

Anëtarët e komitetit diskutuan mbi tema me interes të përbashkët, si planet e qeverisë për vendosjen e TVSH-së për shërbimet/transaksionet bankare, trajtimin e taksimit të dyfishtë dhe qëndrimin/përgjigjet e marra nga DPT së fundmi, si dhe çështjen e taksës së eurobondeve.

Më 10 qershor 2022, Komiteti u mbledh për të diskutuar zhvillimet më të fundit në projektin e Bankës së Shqipërisë për raportimin financiar. Grupi i punës përditësoi anëtarët për indikacionet përkatëse dhe ekspertë ndërkombëtarë rekomanduan hapat e ardhshëm të punës, të cilët theksuan rëndësinë e vlerësimit të rezultateve në një mjedis testimi. Gjithashtu, pjesëmarrësit diskutuan dhe ndanë përvoja për çështjen e zhvlerësimit të vlerës me AFS. U theksua rëndësia e çështjeve të tjera si taksimi i dyfishtë, ligji për eurobondet dhe ligji për sigurimin e depozitave. U ra dakord që AAB-ja duhet të rikërkojë vëmendjen e institucioneve shtetërore për shumë çështje që janë ngritur nga sektori.

Më 13 korrik 2022, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së dhe CFO-të e bankave morën pjesë në takimin e organizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me praninë e Zëvendës Ministres, znj. Vasilika Vjetro. Gjatë takimit u diskutua për çështjet kryesore të bankave dhe konkretisht për dispozitën për "Rezervat e borxhit të keq për institucionet financiare" dhe nevojën për të ruajtur të njëjtën qasje bazuar në ligjin aktual, sipas të cilit njihen dispozitat nëse llogariten me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar (SNRF). Në datën 25 korrik, opinionet e përmbledhura të bankave për ndryshimet iu dorëzuan Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, së bashku me propozimin specifik për dispozitën "Rezerva e borxhit të keq për institucionet financiare".

Në datën 22 dhjetor 2022, anëtarët e Komitetit organizuan një takim për të sqaruar qëndrimin e bankave në lidhje me kërkesën e drejtuar më parë Bankës së Shqipërisë për trajtimin kontabël të fitimeve dhe humbjeve kapitale të perealizuara nga titujt e AFS-së.

### Komiteti Ligjor

DGjatë vitit, anëtarët e Komitetit u përfshinë në procesin e konsultimit të disa projektligjeve dhe rregulloreve.

Më 28 qershor 2022, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së dhe përfaqësues të bankave nga Komitetet Ligjore dhe të Përputhshmërisë morën pjesë në takimin e organizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë znj. Delina Ibrahimaj. Në takim u diskutua projektligji i ri "Për Amnistinë Fiskale dhe Penale". AAB i përcolli Ministrisë shqetësimet e sektorit bankar, në veçanti: domosdoshmërinë e konsultimit të një projektligji të tillë me Institucionet Ndërkombëtare (BE, FMN, BQE), nevojën për një dispozitë të qartë për përjashtimin ose jo nga detyrimet e ligjit. për AML-në dhe FTF-në, nëse bankat do të raportojnë këto llogari siç kërkohet nga Standardet e Përbashkëta të Raportimit (CRS) si dhe nga detyrimet e FATCA, dhe rëndësinë e

përfshirjes së sektorit bankar në procesin e konsultimit të udhëzimeve që do të nxirren sipas këtij ligji. Lidhur këtë çështje janë organizuar takime të tjera teknike me sektorin bankar.

Më 7 tetor 2022, në mbledhjen e Komitetit Ligjor të AAB-së u diskutuan ndryshimet e mundshme të udhëzimit të Bankës së Shqipërisë "Për ekzekutimin e detyrimeve për shumat e llogarive bankare". Në takimin e mëparshëm të zhvilluar në ambientet e Bankës së Shqipërisë, anëtarët ranë dakord për ndryshimin e afateve, sqarimin e sekuestrimit konservator, heqjen e mirëpërcaktuar të sekuestrimit, si dhe çdo mundësi për komunikim elektronik. Komiteti vendosi të dalë me një propozim, i cili duhet të paraqitet dhe diskutohet me Bankën e Shqipërisë.

Më 11 nëntor 2022, anëtarët e Komitetit u mbledhën dhe diskutuan vendimin e Gjykatës Kushtetuese (u ra dakord që të mbahet një takim pas publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare). Gjithashtu, anëtarët theksuan ndryshimet e nevojshme në udhëzimin e Bankës së Shqipërisë "Për ekzekutimin e detyrimeve për shumat e llogarive bankare"; dhe për qëndrimin/reagimin lidhur me rastet e fundit të numrit të madh të urdhrave të bllokimit dhe ekzekutimit të paraqitur nga disa përmbarues privatë.

Komiteti bashkëpunoi me studion ligjore të zgjedhur nga AAB-ja për të përfaqësuar AAB-në në Gjykatën Kushtetuese për çështjen e paraqitur nga një gjyqtar i Gjykatës së Rrethit të Tiranës, për shqyrtimin përfundimtar të ligjshmërisë së nenit 511 pika 5 "d" të KPRC-së (neni që lidhet me sanksionet ligjore të parashikuara në urdhrat e ekzekutimit). Komiteti u angazhua në procesin e shqyrtimit të kërkesave përfundimtare të paraqitura nga Studioja Ligjore në Gjykatën Kushtetuese në emër të AAB-së.

### **Komiteti i Përputhshmërisë**

Nisur nga çështja e identifikimit të të huajve të ngritur nga përfaqësues të Komitetit të Përputhshmërisë, më 26 prill 2022, Zyra Ekzekutive e AAB-së i ka dërguar një letër Guvernorit dhe Drejtorit të Përgjithshëm të NJIF-it dhe ka njoftuar Ministrin e Financave dhe Ekonomisë, duke kërkuar që këto institucione të nxjerrin udhëzimet e nevojshme për bankat, lidhur me një shkresë zyrtare të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për mënyrën e identifikimit të të huajve. AAB-ja kërkonte sqarime të mëtejshme për procedurën që duhet ndjekur nga bankat, duke pasur parasysh kuadrin ligjor dhe atë rregullator.

Më 22 qershor 2022, përfaqësuesit e Komitetit të Përputhshmërisë së AAB-së morën pjesë në një takim të përbashkët të organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në takim u diskutua kryesisht për kuadrin ligjor dhe praktikën e bankave për mbajtjen e të dhënave të pronësisë dhe kontabilitetit, kërkesat e vigjilencës së duhur ndaj klientit dhe njohja e klientit, qasja në informacionin bankar, ndërveprimi me autoritetet rregullatore dhe ndërveprimi me autoritetet kompetente.

### **Komiteti i Burimeve Njerëzore**

Gjatë takimeve të tyre, Komiteti diskutoi çështje të përgjithshme si bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar për sa i përket trajnimit dhe veçanërisht partneritetin afatgjatë me ATTF-në e Luksemburgut, rregulloren mbi të dhënat elektronike shëndetësore dhe tema të tjera me interes të përbashkët.

Më 29 dhjetor 2022, AAB-ja mirëpriti anëtarët e Komitetit të BNJ, të cilët mbajtën takimin e fundvitit. Për më tepër, anëtarët diskutuan për sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë vitit dhe mënyrën e bashkëpunimit në të ardhmen.

### **Komiteti i Rrezikut**

Më 28 tetor 2022, anëtarët e Komitetit të Rrezikut u mbledhën për një mëngjes biznesi. Në një atmosferë miqësore, pjesëmarrësit diskutuan për çështje që prekin punën e tyre të përditshme, si dhe ndanë propozime për aktivitete të ardhshme të mundshme që do të organizohen vitin e ardhshëm.

AAB-ja solli në vëmendjen e Bankës së Shqipërisë rritjen e kërkesës për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme të testimeve të stresit, të cilat kërkohen nga struktura të ndryshme të institucionit mbikëqyrës dhe ndonjëherë mbivendosen me njëra-tjetrën. Me anë të një letre drejtuar BSH-së, u kërkua mundësia e rishikimit të shpeshtësisë dhe afateve për disa aktivitete testimi.

### **Komiteti i Auditimit**

Anëtarët e komitetit u mbledhën për të diskutuar më tej për aktivitete të ardhshme që do të organizohen gjatë vitit, duke përfshirë trajnimet. U diskutuan gjerësisht kërkesat rregullatore për rolin e auditimit të brendshëm në banka dhe pritshmëritë në këtë kontekst.

Në maj, gjatë Muajit Ndërkombëtar të Ndërgjegjësimit të Auditimit të Brendshëm, anëtarët e komitetit organizuan leksione

të hapura për të rritur ndërgjegjësimin mbi rolin dhe funksionet e auditimit të brendshëm. Leksionet u mbajtën nga Ilir Rudi, Dorida Stambolla, Ediola Biçaku dhe Glejda Hibrat, Drejtues të Departamenteve të Auditimit të Brendshëm ku morën pjesë studentë të Universitetit Epoka dhe Universitetit Evropian të Tiranës.

Më 14 tetor 2022 u organizua seminari i Komitetit të Auditimit të AAB-së. Pjesëmarrësit ndanë përvojat e tyre dhe diskutuan sfidat e pritshme të Auditimit të Brendshëm.

### **Komiteti i TI-së dhe Sigurisë së Informacionit**

Komiteti i TI-së dhe Sigurisë së Informacionit u mblodh për të shkëmbyer informacione dhe përvoja mes anëtarëve dhe për të trajtuar çdo situatë të mundshme të sulmeve kibernetike në industrinë bankare.

Duke pasur parasysh se siguria kibernetike dhe rreziqet kibernetike janë shndërruar në një problematikë me prioritet, më 21 shtator 2022, Komiteti i TI-së dhe TIK mbajti një takim për të diskutuar çështjet që lidhen me kibernetikën. Anëtarët reflektuan mbi ndikimin e sulmeve kibernetike kundër sulmeve të shërbimeve të qeverisë shqiptare gjatë vitit dhe nevojën për bashkëpunim në industri dhe shkëmbim informacioni për të rritur ndërgjegjësimin për çështjet e sigurisë kibernetike në sektorin bankar.

### **Komiteti ndihmës i pagesave, kartave, digjitalizimit dhe kanaleve alternative**

Në kuadër të përgatitjes së Forumit "Digjitalizimi kundrejt Parasë Cash", anëtarët e komitetit zhvilluan disa takime për të shtjelluar të gjitha komentet dhe sugjerimet e bankave anëtare lidhur me prezantimin e shqetësimeve dhe problematikave të sektorit, pjesë e agjendës së forumit dhe prezantuar nga kryetarja e Komitetit, znj. Irida Huta. Agjenda e forumit përfshinte problematikën që lidhen me reduktimin e parave cash, digjitalizimin dhe qasjen në e-Albania.

Më 11 mars, Komiteti Ndihmës i Pagesave, Kartave, Digjitalizimit dhe Kanaleve Alternative të AAB-së organizoi një takim për të diskutuar projekt-rregulloren "Për autentifikimin e thelluar të klientit dhe standardet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit". Në bazë të diskutimeve të zhvilluara, AAB-ja paraqiti në Bankën e Shqipërisë një propozim për shtyrjen e afatit për zbatimin e kërkesave të kësaj projekt-rregulloreje. Për sa i përket kësaj rregulloreje, AAB-ja ka paraqitur komentet e përmbledhura përmes një letre drejtuar Departamentit të Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë.

### **Task Forca për Urgjencat e Sigurisë Kibernetike**

Në tetor 2022, me vendim të Asamblesë së AAB-së, u krijua Task Forca e AAB-së për Urgjencat e Sigurisë Kibernetike, e përbërë nga përfaqësues nga të gjithë anëtarët e AAB-së. Gjithashtu, në takime ishin të ftuar përfaqësues të Bankës së Shqipërisë. Më 19 tetor 2022 u zhvillua takimi i parë dhe diskutimet u fokusuan gjerësisht në misionin kryesor të kësaj Task Force dhe rregulloren e saj operacionale. z. Reglënd Xhango, i Intesa Sanpaolo Bank Albania u zgjodh Drejtor i Task Forcës.

Task Forca e AAB-së për Sigurinë Kibernetike organizoi dy takime në muajin nëntor, përkatësisht më 11 dhe 25 nëntor. Bankat dhe përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë u angazhuan në mënyrë aktive në takim dhe diskutuan shqetësimet e ngritura në lidhje me periudhën aktuale. Anëtarët kërkuan ndërhyrje nga AAB-ja lidhur me afatin e informacionit të kërkuar nga AKCESK-u.

Më 9 dhjetor, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, së bashku me Drejtorin e Task Forcës, zhvilluan një takim me Drejtorin e ri të Përgjithshëm të AKCESK-ut. Çështja e sigurisë kibernetike dhe nevoja për një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet palëve për sigurinë kibernetike dhe trajnimin e ndërsjellë ishin ndër temat më të rëndësishme me interes të diskutuara gjatë takimit.

### **Takimi i posaçëm**

#### **Takimi me grupin e punës së marketingut**

Më 4 janar 2022, grupi i punës së marketingut zhvilloi takimin e tij të posaçëm. AAB-ja kërkoi bashkëpunim me përfaqësuesit e bankave për sa i përket edukimit financiar dhe organizimit të nismave të përbashkëta. Grupi i punës përbëhet nga drejtues të departamenteve të marketingut të bankave anëtare.



# 8. TAKIME TË TJERA

## 8.1 Angazhimi me autoritetet dhe institucionet publike

Gjatë vitit, AAB-ja mbajti një komunikim efektiv dhe hapi një dialog konstruktiv me autoritetet dhe institucionet shtetërore për të trajtuar çdo shqetësim apo problem që lidhet me sektorin. U organizuan takime, tryeza të rrumbullakëta dhe forume diskutimi, për të ndërtuar ura më të mira komunikimi ndërmjet anëtarëve të bankave dhe autoriteteve.



### Takimi i industrisë bankare me GDPML-në

- Më 25 janar 2022, u organizua një takim biznesi me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (NjIF) për të diskutuar mundësitë e bashkëpunimit dhe koordinimit për disa çështje me interes të përbashkët. Në takim morën pjesë përfaqësues të bankave nga sektori i Përputhshmërisë dhe ai Ligjor. Në takim mori pjesë edhe Drejtori i Përgjithshëm i NjIF-së Shqiptare, z. Ervin Koçi. Në takim u diskutua për risitë më të fundit të ndryshimeve ligjore të vitit 2021 dhe hapat e mëtejshëm, vigjilencën e ushtruar ndaj "Ilogarisë së posaçme bankare të noterit", ecurinë e Shqipërisë në raportimin pranë ICRG/FATF, mënyrën e plotësimit të RTPF & RAD, çështjet e ndryshme me interes të përgjithshëm të ndeshura gjatë shqyrtimit të RAD-it, etj.
- Më 10 qershor 2022, u organizua një tryezë e rrumbullakët për të diskutuar sugjerimet e bankave për projekt-udhëzimin "Për metodat dhe procedurat e raportimit dhe marrjen e masave parandaluese nga subjektet e ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit". Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët theksuan shqetësimet për projekt-udhëzimin dhe kryesisht për identifikimin elektronik, si dhe propozimet përkatëse të sektorit bankar për këtë çështje.

### Takimi me Drejtorin e Përgjithshëm të Kadastrës

Më 16 mars 2022, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së zhvilloi një takim me Drejtorin e Përgjithshëm të Kadastrës, z. Artan Lame. Gjatë takimit u identifikuan shqetësimet kryesore të sektorit bankar gjatë vitit 2021 dhe u përcaktuan disa nga çështjet në pritje.

### Diskutimi mbi skemën e Garancisë Sovrane

Sektori bankar ka mbështetur nismën e qeverisë për hartimin e skemës së Garancisë Sovrane. Çështja u diskutua në takimin e kryesuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë znj. Delina Ibrahimaj, më 1 prill 2022. Në diskutim morën pjesë përfaqësues të bankave anëtare të AAB-së. Pas takimit, projekt-marrëveshja e garancisë u përcoll nga Ministria dhe dokumenti u kontrollua dhe u shqyrtua nga bankat anëtare. Marrëveshja garanton për subjektet huamarrëse produktet e shportës dhe produkte të tjera të lidhura me to, për të mundësuar financimin e nevojshëm të rezervave për të përballuar situatën e pazakontë të hasur në treg.

### Takimi për përmirësimin e sistemeve të pagesave

Më 7 korrik 2022, AAB-ja organizoi një takim me Bankën e Shqipërisë dhe përfaqësuesit e bankave. Në agjendën e takimit u shtjellua përmirësimi i sistemeve të pagesave AIPS, AIPS EURO dhe AECH.

## 8.2 Takime me institucionet ndërkombëtare

AAB-ja organizoi një sërë takimesh me ekspertë të lartë nga institucione të ndryshme ndërkombëtare, duke ofruar mundësi unike për dialog dhe shkëmbime të nivelit të lartë lidhur me tema të reja dhe me përparësi të veçantë.



### Takim me delegacionin e DG ECFIN-it

Më 15 shkurt 2022, Kryetari i AAB-së së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm të AAB-së morën pjesë në një takim me ekipin e Komisionit Evropian të DG ECFIN-it. Gjatë takimit, palët diskutuan për një sërë çështjesh si zhvillimi dhe stabiliteti i sektorit financiar, nxitja e përdorimit të monedhës kombëtare, përfshirja financiare dhe qasja në financa, ndikimi i legjislacionit për falimentimin në ekzekutimin e kolateralit, financimi i pasurive të paluajtshme, etj.

Në kuadër të takimit të nënkomitetit BE-SHQIPËRI për çështjet dhe statistikave ekonomike dhe financiare që u zhvillua në Tiranë, më 30 shtator 2022, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së, u takua me znj. Sarah Jurreit të DG ECFIN-it. Palët diskutuan dhe shkëmbyen mendime mbi zhvillimet më të fundit në sistemin bankar dhe ekonominë.

### Takim me Korpusin Vullnetar të Shërbimeve Financiare (FSVC)

Më 4 prill 2022, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së zhvilloi një takim me përfaqësues të FSVC-së, në kuadër të zbatimit të programit të tyre për asistencën teknike të organizuar me mbështetjen e Departamentit Amerikan të Shtetit, për asistencën e NJIF-it, Bankës së Shqipërisë, AMF-së dhe DPT-së, për të forcuar mbikëqyrjen e subjekteve të tyre që janë objekt i AML/CFT sipas perimetrit të tyre rregullator, si dhe për të ndërtuar kapacitetet e subjekteve raportuese nëpërmjet trajnimeve për të forcuar nivelin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare.



### **Takim me BERZH-in**

Takimi me ekipin e BERZH-it të përbërë nga ekonomistët rajonalë të BERZH-it, znj. Ana Kresic dhe znj. Olja Belic, u organizua më 4 prill 2022. Ekipi u takua me palë të ndryshme interesi në një mision faktmbledhës për të kuptuar zhvillimet e fundit ekonomike në vend, klimën e investimeve dhe prioritetet e politikave.

### **Takim me përfaqësuesit e Bankës Botërore**

Më 10 maj 2022, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së zhvilloi një takim me grupin e përfaqësuesve të Bankës Botërore, duke përfshirë specialistë të sektorit financiar, i cili u fokusua në kreditimin e sektorit të bujqësisë.

### **Takim për transformimin digjital në pushtetin vendor**

Pas një sërë diskutimesh dhe me kërkesë të Ministrisë së Brendshme për miratimin e asistencës së projektit STAR3 në mbështetje të prioritetëve të qeverisë për transformimin digjital në shërbimet lokale, PNUD-i në bashkëpunim me Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Lokale (AMVV) kreu një vlerësim të aspekteve të qeverisjes vendore për të përcaktuar fazën e gatishmërisë së saj, për të identifikuar boshllëqet dhe për t'i përmirësuar ato. Në kuadër të këtij projekti, më 14 shtator 2022, një mision ekspertësh nga zyra rajonale e PNUD-it që vizituan Shqipërinë, u takuan me Sekretarin e Përgjithshëm të AAB-së gjatë kësaj vizite.

### Takim me përfaqësuesit e FMN-së

Më 30 shtator 2022, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së zhvilloi një takim me përfaqësuesit e FMN-së, të udhëhequr nga znj. Yan Sun, Këshilltare në Departamentin Evropian. Takimi u përqendrua te zhvillimet më të fundit në sektorin bankar, rreziqet për bilancet bankare, nevojën e bankave për mbajtjen e obligacioneve qeveritare, ekspozimin e bankave ndaj sektorit të pasurive të paluajtshme, inflacioni, kursi i këmbimit dhe perspektiva e politikës monetare, zbatimi i SNRF 9, etj.

### Takime informuese

- Më 18 shkurt 2022, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së mirëpriti përfaqësuesit e Agence Française de Développement (AFD), organizuar nga dy ekonomistë nga selia e AFD-së në Paris. Në takim mori pjesë edhe Këshilltari Financiar i Shërbimit Ekonomik Rajonal të Francës në Sofje. Përfaqësuesit vlerësuan, ndër të tjera, pasojat e mundshme makroekonomike dhe socio-ekonomike që mund të sjellin ndryshimet klimatike dhe rreziku i tranzicionit.
- Më 1 mars 2022, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së mirëpriti një grup ekspertësh nga Ambasada Britanike në një takim informues. Ky takim u kërkua në kuadër të vizitës së tyre në Tiranë dhe diskutimet u përqendruan në një përmbledhje të sistemit bankar në Shqipëri, në sfidat kundër pastrimit të parave dhe politikave dhe praktikave në luftën kundër terrorizmit.
- Më 27 prill 2022, Sekretari i Përgjithshëm zhvilloi një takim me përfaqësuesen e SECO-s, znj. Brigitte Bruhin, menaxhere e programit në SECO Bern, përgjegjëse për zhvillimin e sektorit privat. SECO mbështet Shqipërinë në fushën e zhvillimit të sektorit privat nëpërmjet ndërhyrjeve të ndryshme (Këshilli i Investimeve, Zgjidhja e Borxhit & Falimentimi, Raportimi Financiar, Sipërmarrja, etj.). Gjatë takimeve në Shqipëri, përfaqësia e SECO-s u informua mbi sfidat kryesore që prekin aktualisht ndërmjetësimin financiar në vend, nga bankat dhe mikrofinancat e deri te marrja në konsideratë e pengesave të kërkesës dhe ofertës për kredi në sektorin privat.
- Më 17 gusht 2022, Sekretari i Përgjithshëm i AAB-së zhvilloi një takim me përfaqësuesit e IsDB-së dhe ofroi një përmbledhje të sektorit bankar shqiptar. Gjatë takimit, përfaqësuesit shprehën interesin e tyre për kërkesën për financa islame dhe linjat e mundshme tregtare të produkteve dhe zgjidhjeve të financimit të tregtisë islame.



SHIFRA  
RRETH  
BANKAVE  
ANËTARE

Të dhënat e audituara sipas IFRS, në 31.12.2022 ((1 EUR = 114.23 lekë; 1 USD = 107.05 lekë ) (në mijë ALL))

Banka	Struktura e Aksionarëve		Vendi i origjinës	Aktive gjithsej	Hua neto		Investime në letra me vlerë	
					Retail	Biznes	të Qeverisë Shqiptare	të tjera
 AMERICAN BANK OF INVESTMENTS	Tranzit sh.p.k.	100%	Shqipëri	116,267,754	9,758,680	33,453,361	48,016,587	2,799,250
 BANKA KOMBETARE TREGTARE	Calik Holding A.S.	100%	Turqi	491,473,235	43,368,841	44,945,770	143,234,051	148,271,307
 CREDINS bank	Renis Tërshana Aleksandër Pilo B.F.S.E. Holding BV ARMAAR GROUP Bank directors Të tjerë	18.12% 7.67% 15.10% 5.69% 6.88% 46.54%	Shqipëri Shqipëri Hollandë Angli	297,743,538	23,888,295	107,544,970	52,181,744	35,178,818
 First Investment Bank	Fibank AD	100%	Bullgari	50,122,288	11,395,822	13,835,315	12,060,942	648,249
 INTESA SANPAOLO BANK Albania	Intesa Sanpaolo S.p.A.	100%	Itali	192,796,592	15,633,315	38,633,917	66,241,260	6,956,206
 ProCredit Bank	ProCredit Holding AG & Co. KGaA	100%	Gjermani	40,940,973	2,716,115	24,979,802	1,833,348	-
 Pjesë e Grupit RBI	Raiffeisen SEE Region Holding GmbH	100%	Austria	281,577,274	49,843,370	68,433,324	67,903,236	14,223,592
 otpbank	OTP NYRT	100%	Hungari	176,633,751	49,643,802	51,513,432	32,192,853	3,503,686
 TIRANA BANK	Balfin Group	100%	Shqipëri	114,701,806	17,128,948	35,581,113	28,883,082	10,774,340
 UNIONBANK	Unioni Financiar Tirane (UFT) Sh.p.k.	96.46%	Shqipëri	91,852,015	18,839,535	22,839,886	26,623,332	2,603,009
	Individë	3.54%	Shqipëri					
 United Bank of Albania Banka e Bashkuar e Shqipërisë	Eurosig Islamic Development Bank Investitorë të tjerë	66.26% 31.87% 1.87%	Shqipëri Arabia Saudite	12,573,549	2,789,890	5,071,938	-	-
<b>Gjithsej</b>				<b>1,866,682,776</b>	<b>245,006,612</b>	<b>446,832,828</b>	<b>479,170,435</b>	<b>224,958,457</b>

Kapitali i vet	Depozita	Fitimi neto	Nr. i degëve	Nr. i punonjësve	Nr. ATM	Nr. i kartave të lëshuara	Karta Debiti	Karta Krediti	Nr. POS	E-banking	Mobile Banking	E- commerce
11,222,664	76,484,985	1,802,868	21	341	28	21,404	20,346	1,058	-	✓	✓	✓
50,768,935	400,567,680	9,468,974	63	979	114	393,459	348,521	44,938	8,450	✓	✓	✓
19,396,024	263,427,978	1,164,817	50	1,052	71	149,903	143,562	6,341	2,709	✓	✓	✓
4,796,739	38,869,160	879,149	14	425	39	34,351	30,519	3,832	n/a	✓	✓	✗
22,364,641	167,115,012	1,289,763	35	700	64	115,041	113,967	1,074	654	✓	✓	✗
4,084,334	27,022,115	106,213	7	149	16	11,213	11,134	79	-	✓	✓	✓
29,398,670	247,595,216	3,843,446	74	1,275	180	331,211	295,903	35,308	2,644	✓	✓	✓
17,099,007	147,376,492	3,151,394	61	819	213	122,250	115,656	6,594	1,364	✓	✓	✗
9,776,471	97,661,951	1,051,240	33	460	71	68,614	62,136	6,478	232	✓	✓	✗
7,452,380	73,990,818	917,718	32	447	59	58,060	51,065	6,995	178	✓	✓	✓
1,125,700	11,249,002	(337,779)	6	95	-	5,011	5,011	-	-	-	-	-
<b>177,485,564</b>	<b>1,551,360,409</b>	<b>23,337,804</b>	<b>396</b>	<b>6,742</b>	<b>855</b>	<b>1,310,517</b>	<b>1,197,820</b>	<b>112,697</b>	<b>16,231</b>	<b>10</b>	<b>10</b>	<b>6</b>

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit të Pavarur

Shoqata Shqiptare e Bankave

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022



# Përmbajtja

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	i-iii
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	1
PASQYRA E AKTIVITETEVE.....	2
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË.....	3
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE.....	4-9

## Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Drejtimin e organizates “Shoqata Shqiptare e Bankave”,

### *Opinionit*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të “Shoqata Shqiptare e Bankave”, (“më poshtë referuar si “Organizata”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2022, pasqyrën e aktiviteteve dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Organizates me datën 31 dhjetor 2022, pasqyrën e shpenzimeve sipas aktiviteteve dhe flukseve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jo-Fitimprurëse.

### *Bazë për Opinionin*

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesioniste të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### *Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jo-Fitimprurëse, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Organizates për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Organizaten ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizates.

### *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

18 prill 2023

*Mediu Kodra, Flet*

*Mediu*




Grant Thornton  
Sh.p.k.  
NIPT  
K 91923007 M  
Tirana  
ALBANIA

## Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	4	8,080,426	3,752,601
Kontribute të arkëtueshme	5	52,106	937,315
Shpenzime të parapaguara	6	280,160	483,160
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>8,412,692</b>	<b>5,173,076</b>
<b>Aktivët Afatgjatë</b>			
Aktivët e qëndrueshme, neto	7	529,130	657,862
<b>Totali i aktiveve afatgjatë</b>		<b>529,130</b>	<b>657,862</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>8,941,822</b>	<b>5,830,938</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<i>Detyrimet afatshkurtra</i>			
Llogari të pagueshme	8	625,580	676,699
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>625,580</b>	<b>676,699</b>
<b>Aktivët Neto</b>	9	<b>8,316,242</b>	<b>5,154,239</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>8,941,822</b>	<b>5,830,938</b>

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse në faqet 4 deri në 9, pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


Pasqyrat Financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave janë përpiluar më 18 prill 2023 dhe nënshkruar nga:



Spiro BRUMBULLI

Sekretar i Përgjithshëm  
Shoqata Shqiptare e Bankave





PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k

Hartuesi



## Pasqyra e Aktiviteteve

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<b>TË ARDHURAT</b>			
Të ardhura nga kuotat e anëtarësisë	10	29,676,750	24,378,915
Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare	10	1,214,593	4,777,493
Të ardhura të tjera	10	5,451,000	3,651,623
<b>Totali i të Ardhurave</b>		<b>36,342,343</b>	<b>32,808,031</b>
<b>SHPENZIMET</b>			
Amortizimi	7	(120,950)	(150,668)
Shpenzime organizimi për aktivitete	11	(12,018,736)	(11,271,959)
Shpenzime promovimi dhe publikime	12	(2,244,445)	(3,206,910)
Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	13	(18,730,245)	(19,213,499)
Fitime / (Humbjet) nga kursi i këmbimit	14	(59,964)	(43,935)
<b>Totali i Shpenzimeve</b>		<b>(33,180,340)</b>	<b>(33,886,971)</b>
<b>Ndryshimi në aktivet neto</b>		<b>3,162,003</b>	<b>(1,078,940)</b>
Aktivitet Neto në fillim të vitit		5,154,239	6,233,179
<b>Aktivitet Neto në fund të vitit</b>		<b>8,316,242</b>	<b>5,154,239</b>

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse në faqet 4 deri 9, pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## Pasqyra e Flukseve të Parasë

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<i>Fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytëzimit</i>			
<b>Teprica/(Deficiti) i të ardhurave ndaj shpenzimeve</b>		3,162,003	(1,078,940)
Rregullime për:			
Amortizim	7	126,950	150,668
Pakësime për nxjerrje jashtë përdorimi AAM	7	7,662	37,442
Llogari të arkëtueshme	5	885,209	(648,325)
Parapagime	6	203,000	(203,000)
Pagesa për llogaritë e pagueshme	8	(51,119)	(52,234)
<b>Fluksi monetar nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>		<b>4,333,705</b>	<b>(1,794,389)</b>
<i>Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese</i>			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	7	(5,880)	(102,699)
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese</b>		<b>(5,880)</b>	<b>(102,699)</b>
<b>RËNIE NETO E MJETEVE MONETARE</b>		<b>4,327,825</b>	<b>(1,897,088)</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës</b>	<b>4</b>	<b>3,752,601</b>	<b>5,649,688</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës</b>	<b>4</b>	<b>8,080,426</b>	<b>3,752,601</b>

Pasqyra e Flukseve Monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse në faqet 4 deri 9, pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# Shenime për pasqyrat financiare

## 1. Informacion i Përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Bankave ("AAB" ose "Organizata") është themeluar më 14 Prill 1999 me seli në adresën: Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 9, Ap.3, Tiranë, Shqipëri.

Shoqata Shqipëtare e Bankave (AAB) është një shoqatë jo fitimprurëse, e cila përpiket të promovojë standardet më të fundit Bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, duke kontribuar kështu në përparimin e ekonomisë shqiptare. AAB përbëhet nga 11 anëtarë, mbi baza vullnetare: Banka Amerikane e Investimeve sh.a., Banka Credins sh.a., Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a., Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a., Banka Intesa SanPaolo Albania sh.a., Banka Kombëtare Tregtare sh.a., Banka OTP Albania sh.a., Banka Procredit sh.a., Banka Raiffeisen sh.a., Banka Tirana sh.a. dhe Banka Union sh.a.

AAB ka pasur 5 punonjës me 31 dhjetor 2022 (2021: 6).

## 2. Baza e Përgatitjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me SKK për OJF-të dhe ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. SKK për OJF-të ka hyrë në zbatim nga data 1 janar 2016.

Pasqyrat Financiare paraqiten në Lekë (Lekë), e cila është dhe monedha funksionale e Shoqatës.

### (a) Kosto Historike

Elementët në pasqyrat financiare janë njohur me koston historike.

### (b) Parimi i vijmësisë

Pasqyrat financiare përgatiten sipas parimit të vijmësisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e Shoqata Shqiptare e Bankave do të ketë vijmësi, dhe se nuk ka në plan ose nuk do ta ketë të nevojshme ta ndërpresë aktivitetin e saj.

Gjatë vitit 2022 të gjithë donatorët e organizatës kanë disbursuar fondet e tyre në bazë të Statutit të organizatës në përputhje me planin e aktiviteteve për vitin 2022. Kësti i fundit i vitit 2022 është miratuar me vendim të Asamblesë të datës 14.12.2022. Asambleja e përgjithshme e organizatës me vendimin nr.5 datë 15.12.2021 ka miratuar planin financiar për vitin 2022 në shumën totale 38,570,092 lekë.

Organizata vijon me implementimin e masave për parandalimin e ndikimeve negative të Pandemisë në aktivitetet e saj dhe vlerëson se do të vijoje aktivitetin bazuar mbi parimin e vijmësisë, për një periudhë kohe të paktën për 12 muajt e ardhshëm.



### 3. Përmbledhje e Politikave Kontabël

#### I. Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Të ardhurat njihen me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme. Shpenzimet njihen në të njëjtën periudhë si të ardhurat që lidhen me to.

Të ardhurat kryesore të Shoqatës vijnë nga tarifat e anëtarësimit, të cilat janë subjekt i miratimit të Asamblesë së Anëtarëve.

Të ardhurat regjistrohen kur realizohen dhe shpenzimet regjistrohen kur ndodhin.

#### II. Transaksionet në monedhë të huaj

AAB përdor si monedhë bazë Lek-un. Të gjitha kontributet dhe pjesa më e madhe e shpenzimeve janë në Lekë. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin e datës së kryerjes së transaksionit. Të gjitha balancat në monedhë të huaj në fund të vitit janë konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e fundit të vitit si vijon:

Kursi i këmbimit më

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
LEK€/EUR	114.23	120.76

#### III. Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)

Vlerësimi fillestar i elementeve që plotësojnë kriteret e njohjes si AAM në bilanc është bërë me koston e blerjes plus kostot e tjera të drejtpërdrejta, që lidhen me sjelljen e aktivitetit në vendndodhje dhe kushtet e nevojshme për funksionimin e tij, sipas qëllimeve të Shoqatës. Vlerësimi vijues është bërë sipas modelit të koston dhe AAM-të paraqiten në bilanc në vlerën neto (minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e mundshme nga zhvlerësimi, nëse ka). Amortizimi fillon të regjistrohet që nga muaji pasardhës i atij të blerjes.

Normat e amortizimit dhe metoda sipas grupeve:

	Norma e Amortizimit	Metoda e përdorur
Pajisje informatike	25%	Vlera e mbetur
Mobilje dhe Orendi	20%	Vlera e mbetur
AAM të tjera	20%	Vlera e mbetur

#### IV. Tatimet dhe Taksat

AAB është një shoqatë jo fitimprurëse dhe, si e tillë, është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në Shqipëri. AAB është subjekt i tatimit në burim, i tatimit mbi të ardhurat personale dhe i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe taksave vendore.

#### 4. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Arka dhe banka përbëhen nga sa më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Llogari rrjedhëse në Lekë	7,760,482	2,611,788
Llogari rrjedhëse në Euro	284,371	1,099,007
Para në arkë	35,573	41,806
<b>Gjithsej</b>	<b>8,080,426</b>	<b>3,752,601</b>

#### 5. Kontribute të arkëtueshme

Kontributet e arkëtueshme përbëhen nga sa më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Te arkëtueshme prej anëtarëve	44,142	937,315
Të arkëtueshme nga Furnitorë	6,996	-
Paga të arkëtueshme	968	-
<b>Gjithsej</b>	<b>52,106</b>	<b>937,315</b>

#### 6. Shpenzime të parapaguara

Shpenzime të parapaguar përbëhen nga sa më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Garanci qira	280,160	280,160
Parapagime	-	203,000
<b>Gjithsej</b>	<b>280,160</b>	<b>483,160</b>

#### 7. Aktivet Materiale Afatgjata

Aktivët e Qëndrueshme përbëhen nga sa më poshtë:

	Mobilje / Orendi	Pajisje Kompjuterike	Gjithsej
<b>Kosto</b>			
Në 31 Dhjetor 2021	1,919,189	1,291,756	3,210,945
Shtesat gjatë vitit 2022	-	-	-
Pakësimi gjatë vitit 2022	9,445	-	9,445
<b>Në 31 Dhjetor 2022</b>	<b>1,909,744</b>	<b>1,291,756</b>	<b>3,201,500</b>
<b>Amortizimi i Akumuluar</b>			
Në 31 Dhjetor 2021	1,656,007	897,075	2,553,082
Amortizimi gjatë vitit 2022	28,280	98,670	126,950
Pakësimi gjatë vitit 2022	(7,662)	-	(7,662)
<b>Në 31 Dhjetor 2022</b>	<b>1,676,625</b>	<b>995,745</b>	<b>2,672,370</b>
<b>Vlera Neto</b>			
Në 31 Dhjetor 2021	263,182	394,681	657,862
Në 31 Dhjetor 2022	233,119	296,011	529,130

## 8. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme përbëhen nga sa vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Tatimi mbi të ardhurat personale	389,461	416,017
Kontributet e Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	221,972	246,534
Te pagueshme per personelin	-	2,148
Furnitorë	-	12,000
Tatim në Burim	14,147	-
<b>Gjithsej</b>	<b>625,580</b>	<b>676,699</b>

## 9. Aktivet Neto

Aktivi neto është diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve të AAB në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.

Ndryshimi në aktivet neto, paraqitur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, artikullohet në aktivet neto të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar.

Aktivët neto përdoren në periudhat vijuese vetëm për objektivat e përcaktuara në statutin e ABB.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Balanca e mbartur në fillim të periudhës	5,154,239	6,233,179
Rritje/(Ulje) në aktivet neto	3,162,003	(1,078,940)
<b>Balanca e mbartur në vitin e ardhshëm</b>	<b>8,316,242</b>	<b>5,154,239</b>

## 10. Të ardhurat

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Tarifa anëtarësimi nga bankat anëtare	29,676,750	24,378,915
Sponsorizime nga bankat	1,214,593	4,777,493
Të ardhura nga trajnime për bankat anëtare	5,451,000	3,651,623
<b>Gjithsej</b>	<b>36,342,343</b>	<b>32,808,031</b>

### 11. Shpenzime organizimi për aktivitete

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Trajnime për bankat anëtare	5,981,089	7,560,845
Evente dhe Workshop	4,563,473	2,665,984
Anëtarësime	1,012,620	1,045,130
Udhëtime	461,554	-
<b>Gjithsej</b>	<b>12,018,736</b>	<b>11,271,959</b>

### 12. Shpenzime promovimi dhe publikime

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Publikime	2,192,485	3,155,310
Materiale informative dhe publicitet	51,960	51,600
<b>Gjithsej</b>	<b>2,244,445</b>	<b>3,206,910</b>

### 13. Shpenzimet të përgjithshme dhe të administrimit

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Paga personeli	11,632,384	12,054,391
Qira	2,864,760	2,943,100
Kontribute për sigurime	1,302,033	1,389,301
Shpenzime komunikimi	833,347	1,236,068
Shpenzime konsulence	1,026,687	540,000
Shpenzime të tjera	405,759	358,112
Kancelari dhe të tjera të konsumueshme	258,559	219,068
Sigurim shëndeti	179,759	184,605
Shpenzime utilitare	139,807	133,940
Shpenzime pastrimi	3,973	12,000
Shërbime përkthimi	-	44,731
Komisione bankare	39,457	29,575
Taksa lokale	15,000	15,000
Abonime	17,872	12,008
Noterizime	10,848	41,600
<b>Gjithsej</b>	<b>18,730,245</b>	<b>19,213,499</b>

Në muajin shtator 2021, 4 (katër) punonjës kanë nënshkruar Kontratë Individuale për anëtarësimin në fondin e pensionit vullnetar "Sigal". Sipas këtyre kontratave, punonjësve u lind detyrimi për të paguar kuotën mujore të kontributit në këtë skemë. Është dakordësuar që kuota të mbahet nga paga e tyre dhe të derdhet në llogarinë bankare të shoqërisë "Sigal Uniqa Group Austria" nga Shoqata Shqiptare e Bankave.

#### 14. (Fitime) / Humbjet nga kursi i këmbimit

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Humbje nga këmbimet valutore	93,705	96,169
Fitime nga këmbimet valutore	(33,216)	(52,234)
Të ardhura nga interesat	(525)	-
<b>Gjithsej</b>	<b>59,964</b>	<b>43,935</b>

#### 15. Angazhime dhe detyrime të kushtezuara

##### *Çështje ligjore*

Më 31 dhjetor 2022, nuk ka çështje gjyqësore të ngritura kundër Organizates apo nga Organizata.

##### *Angazhime për qera*

Organizata ka angazhime për kontratën e qerasë për ambientet për zhvillimin e akviteve për periudhën maksimumi deri në një vit.

#### 16. Transaksione me palët e lidhura

Organizata ka pasur transaksione me palët e lidhura përgjatë rrjedhës normale të biznesit. Transaksionet kryesore janë ato të lidhura me fondet e marra nga Bankat.

#### 17. Ngjarjet pas datës së raportimit

Drejtimi i Organizatës nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullime apo shpjegime shtesë në këto pasqyra financiare.



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE